

GLPS thotë se 30 vendime të qeverisë në largim janë të kundërligjshme



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DEPUTETI I PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK), PËRPARIM GRUDA, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE NË LIDHJE ME PROCESIN E ÇLIRIMTARËVE NË HAGË

PDK-ja: REFUZIMI I MBROJTJES NË LIRI I KRERËVE TË UÇK-së NË HAGË, SHKELJE E TË DREJTAVE TË NJERIUT



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është shprehur e indinjuar lidhur me refuzimin e kërkesës për mbrojtje në liri për Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin nga Dhomat

e Specializuara në Hagë. Deputeti i kësaj partie, Përparim Gruda, ka thënë se ky vendim cenon të drejtat themelore të njeriut, të të akuzuarve, të cilat janë të garantuara nga Kushtetuta e

Republikës së Kosovës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës që të marrin rol aktiv në ofrimin e garancive për çlirimtarët në Hagë

26 VJET NGA MASAKRA NË BURGUN E DUBRAVËS, NDËR AKTET MË ÇNJERËZORE TË REGJIMIT SERB NDAJ SHQIPTARËVE F.4



OFERTA PUNE ENDE PA E MARRË DIPLOMËN: KOSOVA, 'FABRIKË' E MJEKËVE QË IKIN JASHTË F.3



KALLASI NË BEOGRAD: SERBIA DUHET TA DËSHMOJË SE E KA PËRNJËMEND ANËTARËSIMIN NË BE F.2

U NDALOHET LINJA NDËRKOMBËTARE DISA AUTOBUSËVE PASI NUK E KISHIN KRYER KONTROLLIN TEKNIK GJASHTËMUJOR F.6

VENGU NË TAKIM ME JASHARIN: KOSOVËN DO TA BËJMË PJESË TË PLOTË TË ARKITEKTURËS SË SIGURISË EUROATLANTIKE F.6

EKONOMI



AKB-ja: PROTESTAT JANË TË PASHMANGSHME, NUK MUND TA PRANOJMË KËTË PADREJTËSI ENERGETIKE F.8

BQK-ja VLERËSOHET PËR AVANCIMIN E REFORMAVE INSTITUCIONALE, ZHVILLIMIN E SEKTORIT FINANCIAR DHE FORCIMIN E QËNDRUESHMËRISË F.8

SPORT



TREPÇA KRENOHET ME SUKSESE, BASHKIMI SYNON TË RIKTHEHET MË I FORTË F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
Fax: +389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com



FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kallasi në Beograd: Serbia duhet ta dëshmojë se e ka përnjëmend anëtarësimin në BE

PRISHTINË, 22 MAJ - Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, ka thënë se Serbia duhet ta dëshmojë me vepra dhe reforma se synon vërtet të anëtarësohet në BE. Në një konferencë për medie në Beograd, Kallasi tha se me zyratë të lartë serbë bisedoi për anëtarësimin në BE, dialogun e Brukselit dhe për çështje të tjera. “Është e qartë se anëtarësimi në BE mbetet synim strategjik i Serbisë, megjithatë dua të theksoj se ne duhet të shohim veprime që e dëshmojnë këtë dhe i mbështesin këto fjalë. Reformat janë ato që tregojnë se si Serbia do të ecë përpara në rrugën e saj drejt BE-së”, tha Kallasi. Ajo theksoi se përparimi duhet të ndodhë “këtu në Beograd” dhe shtoi se hapat e radhës që Serbia duhet t’i ndërmarrë janë shumë të qartë dhe ata përfshijnë lirinë e medias, luftën kundër korrupsionit dhe reformat zgjedhore. “Reformat do të sjellin

përfitime të vërteta për qytetarët dhe popullin e Serbisë, siç kanë kërkuar qindra mijëra studentë në javët e fundit. Autonomia e universiteteve duhet të respektohet. E ardhmja e Serbisë në BE varet nga vlerat që ajo zgjedh t’i ndjekë”, tha ajo. Kallasi nënvizoi se lidhjet e Serbisë me fqinjën e saj, Kosovën, nuk kanë të bëjnë vetëm me përmirësimin e marrëdhënieve, por janë “vendimtare” për të ardhmen e Serbisë në BE. “Ka ardhur koha të tejkalohet e kaluara dhe të përqendroheni në të ardhmen e përbashkët. Planifikoj t’i ftoj në Bruksel përfaqësuesit e Beogradit dhe Prishtinës së më shpejt për të folur për hapat konkretë përpara”, nënvizoi ajo. Sipas saj, dialogu ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për normalizimin e marrëdhënieve është “domosdoshmëri për të lëvizur përpara” në atë drejtim. “Tani është koha për riangazhim”, ka shkruar Kallasi në llogarinë e saj në



platformën X. Kallasi tha se është “thellësisht e përkushtuar” për t’i inkurajuar të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor që të shfrytëzojnë “me të vërtetë momentumin aktual që kemi në procesin e zgjerimit”. “Po, ky proces ka qenë në zhvillim prej mjaft kohësh, por gjithmonë ekziston një moment politik, e ky moment politik është tani - Evropa e Bashkuar është një vizion për të cilin duhet të punojmë të gjithë”, theksoi ajo. Kryediplomatja e BE-së do ta

qëndrojë në Kosovë të enjten në kuadër të turneut rajonal që e ka nisur më 21 maj me vizitë në Serbi. Gjatë vizitës në Beograd, Kallasi është takuar në natën e së mërkurës me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili ka thënë se vendi i tij “mbetet partner i besueshëm për të gjithë që synojnë duan bashkëpunim, përparim dhe një të ardhme të përbashkët evropiane”. Presidenti i Serbisë ka shkruar, në një postim në llogarinë e tij, në rrjetin social “Instagram”, se me

Kallasin ka biseduar për çështje kyç gjeopolitike, për situatën e sigurisë në rajon, për rrugën evropiane të Serbisë dhe për dialogun me Kosovën. Ai ka thënë se Kallasi i ka theksuar se “Serbia është e vendosur për dialog konstruktiv me ndërmjetësimin e BE-së, si mënyrë për zgjidhjen e çështjeve të hapura, dhe se mbrojtja e serbëve në Kosovë është prioriteti ynë absolut”. Vuçiqi ka thënë se ia ka kujtuar kryediplomates së BE-së se “Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe nuk është vetëm obligim për të cilin jemi marrë vesh, por edhe një parakusht për përparim të mëtejshëm në dialog dhe për çfarëdo normalizimi marrëdhëniesh”. Ajo është takuar edhe me kryeministrin Gjuro Macut, si dhe ministrin e Jashtëm, Marko Gjuriq, atë për Integritet Evropian, Nemanja Starović, dhe kryetaren e Kuvendit, Ana Bernabiq, dhe grupet parlamentare opozitare.

Ca bukë e ushqim foshnjash mbërrijnë në Gazë, palestinezët kërkojnë më shumë

GAZA, 22 MAJ - Furnizimet me miell dhe ushqim kanë filluar të mbërrijnë te disa nga banorët më të prekur në Rripin e Gazës, pasi Izraeli lejoi hyrjen e më shumë kamionëve me ndihma. Megjithatë, këto furnizime nuk do t’i mbulojnë aspak mungesat e shkaktuara nga bllokada 11-javore, kanë thënë zyrtarët palestinezë. Izraeli tha se i lejoi 100 kamionë, të mbushur gjithashtu me ushqim për foshnja dhe pajisje mjekësore, të futen në Gazë të mërkurën, dy ditë pasi njoftoi se i kishte lehtësuar kufizimet si rrjedhojë e trysnisë ndërkombëtare. Izraeli e vendosi në mars bllokadën ndaj të gjitha furnizimeve, duke thënë se Hamasi po i merrte dërgesat për



t’i përdorur për luftëtarët e vet. Hamasi, i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, ka mohuar akuzat e Izraelit. OKB-ja tha se një e katërta e popullsisë së Gazës prej 2.3 milionë banorësh është në rrezik urie. “Disa furra buke do të fillojnë të marrin miell për të

gatuar bukë dhe presim që shpërndarja e bukës të nisë më vonë sot”, tha për “Reuters”, Amjad al-Shawa, drejtor i Rrjetit të Organizatave Joqeveritare Palestineze në Gazë. Ai tha se vetëm 90 kamionë kishin arritur të hynin. “Gjatë armëpushimit hynin 600 kamionë çdo ditë, që do të thotë se sasia e tanishme është një pikë

në oqean, pra asgjë”, tha ai. Furrat e mbështetura nga Programi Botëror i Ushqimit i OKB-së do ta gatuajnë bukën dhe stafi i agjencisë do ta shpërndajë atë. Kjo do të bëhet në mënyrë më të kontrolluar sesa më parë, kur bukëpjekësit e shisnin bukën drejtpërdrejt te banorët me çmim të ulët, shtoi ai. “Ideja është të përqijemi të arrijmë te familjet më në nevojë, ato që janë në gjendje të shpërndajë, pasi ky është vetëm fillimi”, tha Shawa. Derisa ndihmat e para mbërritën pas bllokadës, sulmet ajrore izraelite në Gazë vranë të paktën 35 palestinezë në të gjithë enklavën të enjten, sipas autoriteteve lokale shëndetësore. Ushtria izraelite nuk i ka komentuar ende këto raportime.


Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, tha të mërkurën se Izraeli do të ishte i hapur për armëpushim të përkohshëm për ta mundësuar kthimin e pengjeve izraelite nga Gaza. Por, ai tha se, nëse ato nuk kthehen, Izraeli do ta vazhdojë fushatën ushtarake për ta marrë kontrollin e plotë të Gazës. Lufta në Gazë filloi kur militantët të udhëhequr nga Hamasi sulmuan Izraelin jugor, duke vrarë 1 200 njerëz dhe duke marrë rreth 250 pengje. Izraeli thotë se 59 pengje mbeten në Gaza, megjithëse besohet se rreth 35 prej tyre janë të vdekur. Prej atëherë, lufta e Izraelit i ka vrarë më shumë se 53 000 njerëz në Gazë, shumë prej tyre gra dhe fëmijë, sipas zyrtarëve shëndetësorë palestinezë.

Vriten dy punonjës të Ambasadës së Izraelit në Uashington, arrestohet i dyshuari

UASHINGTON, 22 MAJ - Dy pjesëtarë të stafit të Ambasadës së Izraelit, një çift i ri që do të fejohej së shpejti - janë vrarë nga një sulmues i vetëm, teksa ata po largoheshin nga një ngjarje e zhvilluar në Muzeun Hebraik në Uashington, në natën e së mërkurës, sipas kohës lokale, kanë njoftuar autoritetet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një i dyshuar për vrasjet tashmë është arrestuar, kanë

njoftuar zyrtarët amerikanë. Dy viktimat janë qëlluar dhe janë vrarë në një pjesë të qendrës së Uashingtonit, e cila ndodhet vetëm dy kilometra larg Shtëpisë së Bardhë, raporton “Reuters”. Shefja e Policisë Metropolitane të Uashingtonit, Pamela Smith, ka thënë se një burrë ka shtënë ndaj një grupi prej katër personash me një revole, duke i qëlluar të dyja viktimat. Ai ishte parë duke vrapuar jashtë muzeut para sulmit.

I dyshuari i vetëm, i identifikuar si Elias Rodriguez, 30-vjeçar nga Çikagoja, kishte brohoritur “Liri për Palestinën, liri për Palestinën”, para se të arrestohej, ka thënë ajo. “Pas të shtënave, i dyshuari është futur në muze dhe është ndaluar nga siguri i ngjarjes”, ka thënë Smith. “Sapo është prangosur, i dyshuari ka treguar se ku e ka hedhur armën, dhe ajo armë është gjetur, dhe ai ka pohuar se e ka kryer krimin”, ka njoftuar ajo.



DEPUTETI I PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK), PËRPARIM GRUDA, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE NË LIDHJE ME PROCESIN E ÇLIRIMTARËVE NË HAGË

PDK-ja: REFUZIMI I MBROJTJES NË LIRI I KRERËVE TË UÇK-së NË HAGË, SHKELJE E TË DREJTAVE TË NJERIUT



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është shprehur e indinjuar lidhur me refuzimin e kërkesës për mbrojtje në liri për Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Deputeti i kësaj partie, Përparim Gruda, ka thënë se ky vendim cenon të drejtat themelore të njeriut, të akuzuarve, të cilat janë të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës që të marrin rol aktiv në ofrimin e garancive për çlirimtarët në Hagë

mundshëm për ndikim në proces ka rënë, lirimi me kusht nuk do të duhej të ishte një privilegj, por një e drejtë e patjetërsueshme”, ka theksuar ai.

Ai ka pohuar se Partia Demokratike e Kosovës ka mbështetur që nga fillimi themelimin dhe funksionimin e papenguar të Gjykatës Speciale, me bindjen e plotë se aty do të garantohej e drejta për një gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm - si gurthemel i lirive dhe të drejtave të njeriut.

PDK-ja vlerëson se një gjykatë e tillë në zemër të Evropës nuk do të duhej të shndërrohej në një mekanizëm të përndjekjes, aq më pak në emër të drejtësisë dhe viktimave të luftës. “Z. Thaçi, z. Veseli, z. Krasniqi dhe z. Selimi nuk janë aty thjesht si qytetarë të akuzuar, por si liderë të luftës për liri, arkitektë të pavarësisë dhe ndërtues të institucioneve demokratike të Kosovës. Ne kërkojmë një

gjykim të drejtë, të bazuar në standardet e vendeve demokratike, nga të cilat vijnë edhe gjyqtarët e kësaj gjykate. Prandaj, kërkojmë respektimin e të drejtave të të akuzuarve, kërkojmë që humanizmi të mos zhduket përballë paragjytimeve, dhe që ligji të mos shtypet në emër të drejtësisë. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, u bëjmë thirrje Dhomat e Specializuara, faktorit ndërkombëtar dhe atyre që financojnë gjykatën, të veprojnë me përgjegjësi dhe respekt për të drejtat themelore të njeriut”, është shprehur Gruda.

Gruda u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës që të marrin rol aktiv në ofrimin e garancive për të akuzuarit. “Jemi të bindur se procesi në Hagë dhe epilogu i tij nuk janë çështje individuale, por çështje me rëndësi themelore për historinë dhe të ardhmen e shtetit tonë. Mosangazhimi i

institucioneve tona nuk është thjesht një neglizhencë, por një heqje dorë nga përgjegjësia historike”, ka theksuar Gruda. Një ditë më parë edhe deputeti tjetër i kësaj partie, ish-këshilltari i Hashim Thaçit, Artan Behrami, ka thënë se ka plot persona që kanë përcjell procesin e gjyqit në Hagë, që kanë shpresuar se krerët e UÇK-së mund të lirohen e të mbrohen në liri, pasi Prokuroria t'i përfundojë dëshmitarët e saj. “Edhe vetë e kam pasur një troh shpresë. Refuzimi nga paneli gjyqësor është indikator dhe shenjë e qartë se Gjykata Speciale kundër krejt ligjeve dhe konventave ndërkombëtare do t'i dënojë krerët e UÇK-së. Tani nuk ka më dilema, nuk ka më kalkulime! Tani është koha që i madh e i vogël, me krejt fuqinë dhe mjetet demokratike, duhet të kundërshtojmë këtë proces politik me të vetmen kërkesë: gjyq fer, të pavarur dhe sovran”, ka thënë Behrami.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 MAJ - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Përparim Gruda, është shprehur i indinjuar lidhur me refuzimin e kërkesës për mbrojtje në liri për Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Gruda në një konferencë për

medie të enjten tha: “Mbajtja e tyre, së bashku me ish-presidentin Thaçi, për më shumë se katër vjet e gjysmë në paraburgim, përbën shkelje flagrante të standardeve të drejtësisë perëndimore, standarde të cilat kemi besuar se do të respektoheshin me përpikëri nga kjo gjykatë. Pas përfundimit të fazës së Prokurorisë, kur çdo argument për ndonjë rrezik të

Krasniqi takon Këshillin Politik të PDK-së, flasin për zhvillimet në vend



PRISHTINË, 22 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka takuar të enjten Këshillin Politik të PDK-së, personalitete me përvojë të jashtëzakonshme, me kontribut të çmuar ndër vite dhe me dije të thellë për zhvillimet politike dhe shtetërore në vendin tonë.

“Diskutuam hapur për udhëkryqin politik ku ndodhet Kosova sot, për sfidat e mëdha socio-ekonomike, për organizimin e brendshëm të partisë para zgjedhjeve lokale, por edhe për zhvillimet në Dhomat e Specializuara në Hagë. Në një periudhë kaq të ndjeshme për vendin, ndihemi më të

sigurt dhe më të vendosur kur kemi pranë një elitë të tillë politike - të gatshëm për të dhënë mendim, për të ndihmuar me përvojë dhe për të kontribuar me përgjegjësi për të ardhmen e Kosovës. Mirënjohës për bashkëbisedimin dhe angazhimin e secilit prej tyre”, ka thënë Krasniqi.



OFERTA PUNE ENDE PA E MARRË DIPLOMËN: KOSOVA, 'FABRIKË' E MJEKËVE QË IKIN JASHTË

PRISHTINË, 22 MAJ - Ende pa i përfunduar studimet, Shpresa nga Prishtina i ka siguruar pesë oferta pune në Gjermani dhe në Zvicër. Pas qershorit, kur përfundon studimet për infermieri në një nga kolegjet private në Kosovë, ajo do të pajiset me licencë dhe më pas do ta nisë rrugëtimin jashtë vendit. Punëdhënësit nga të cilët ka marrë ofertat janë duke pritur vetëm konfirmimin e saj, si dhe datën se kur do ta fillojë punën. "Pas shtatë apo tetë muajsh do të jem atje", thotë Shpresa, identiteti i vërtetë i së cilës është i njohur për redaksinë e "Radios Evropa e Lirë".

Pagat e ofruara, sipas saj, janë shumë më të larta sesa paga maksimale prej rreth 840 eurosh bruto që një infermiere mund ta marrë në Kosovë. "Kryesisht janë nga 3 600 deri në 3 800 euro [bruto] për një person. Nga ato zbriten taksat që ndal shteti, e mbetet diku rreth 2 600 deri në 2 700 euro [neto]", thekson Shpresa.

Por, nuk është vetëm paga që e motivon të shpërngulet jashtë Kosovës. Ajo nuk dëshiron të përballet me përvojat e këqija nëpër të cilat, sipas saj, kanë kaluar koleget gjatë konkurseve për punë. "Fatkeqësisht, gjërat në Kosovë shkojnë me të njohur [nepotizëm]. Nuk e kam askënd të njohur. Kështu që, për mua, më primare është të shkoj në vende të huaja sesa të rri në

Kosovë. Atje, diploma kolegjit të njihet, të mirëpresin tamam si infermiere dhe nuk ke nevojë të shikosh se kë ke nënë, babë, apo kë ke të njohur", u shpreh Shpresa.

Ajo nuk është e vetmja që po synon vendet e Bashkimit Evropian. Trendi i largimit të personelit shëndetësor nga Kosova drejt vendeve perëndimore, i cili është shënuar tash e disa vjet, po vazhdon edhe më tej, thonë nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës.

Në rast se ky trend nuk frenohet, sipas kryetares së kësaj federate, Tevide Imeri, vendi rrezikon të mbetet pa mjekë dhe pa infermierë të profileve të ndryshme. "E çuditshme dhe absurde është që Kosova po prodhon punëtorë shëndetësorë, sikur ata të jenë 'ushqim' për ta eksportuar. Institucionet [arsimore] private dhe ato publike janë duke prodhuar kuadro për t'i shitur", thekson Imeri.

Sipas të dhënave të Federatës, por edhe të Odës së Mjekëve të Kosovës, nga viti 2018 e deri më tash, nga vendi janë larguar rreth 850 mjekë, shumica prej të cilëve kanë ikur drejt vendeve perëndimore për arsye punësimi.

Për të njëjtat arsye, sipas tyre, nga Kosova largohen brenda vitit mbi 300 infermierë, për të punuar kryesisht në Gjermani, por edhe në vende të tjera

evropiane.

Një hulumtim i Institutit për Studime të Avancuara - GAP në Prishtinë, i publikuar në tetor të vitit të kaluar, i cili bën krahasimin e punësimit në Gjermani dhe Kosovë, si dhe sektorët dhe pagat sipas fuqisë blerëse, tregon se gjatë viteve 2019 deri më 2023 në sektorin e shëndetësisë në Gjermani janë punësuar gjithsej 9 416 qytetarë të Kosovës.

Ndërkaq, gjatë së njëjtës periudhë, i njëjti sektor në Kosovë ka pasur të punësuar 14 786 persona.

Mjekët dhe infermierët "e humbur"

Kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës, Pleurat Sejdiu, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se vetëm gjatë periudhës së viteve 2018-2022, certifikatën e pastërtisë profesionale nga Oda e kanë marrë rreth 700 mjekë. Kjo certifikatë, sipas tij, është e domosdoshme për punësim, sidomos në Gjermani. Trendi i largimit të mjekëve nga Kosova, thotë ai, ka vijuar edhe në vitet që pasuan e deri më sot. "Në vitin aktual janë 31 [mjekë të larguar] deri më tani. Llogaritet që rreth 90 për qind të atyre që kanë marrë certifikatën kanë shkuar. Ne kemi rreth 850 mjekë që janë larguar nga Kosova. Në përgjithësi, nëse kalkulojmë me ata që përfundojnë Fakultetin e

Mjekësisë në Prishtinë, Tiranë dhe Tetovë, ne kemi afërsisht gjashtë gjenerata të humbura", thotë Sejdiu.

Sistemi shëndetësor publik në Kosovë kryesisht furnizohet me kuadro mjekësh që dalin nga tri universitete: ai i Prishtinës, i Tiranës dhe i Tetovës. Ata duhet të jenë kuadro që ripërtërijnë kompleksin e mjekëve të sistemit shëndetësor publik të Kosovës.

Të dhënat e Odës së Mjekëve të Kosovës, sipas Sejdiut, tregojnë se vitin e kaluar nga këto tri universitete, në tregun e punës në Kosovë kanë hyrë rreth 180 mjekë.

Po më 2024 nga sektori publik shëndetësor janë larguar rreth 220 mjekë, prej të cilëve 111 kanë ikur jashtë vendit, 92 janë pensionuar, ndërkaq 15 mjekë të moshës aktive kanë vdekur. "Do të thotë, ne jemi në minus çdo vit", shpreh Sejdiu.

Megjithatë, ai shton se, mesatarisht, gjatë një viti në Kosovë qëndrojnë të papunësuar rreth 500 mjekë.

Papunësia, sipas tij, është arsyeja e parë pse mjekët ikin për punësim jashtë vendit. Gjeneratat e reja të mjekëve, siç thotë ai, "janë më ambicioze rreth nxënies së dijes" dhe nuk janë të kënaqura me cilësinë e specializimeve që ofrohen në Kosovë. Në fazën e specializimit, paga e mjekëve të rinj sillet rreth 700 euro bruto, thotë Sejdiu, duke shtuar se kjo është dekurajuese për ta.

"Emëruesi i përbashkët i të gjitha këtyre është mungesa e perspektivës për ta në sistemin shëndetësor në Kosovë", thekson Sejdiu.

Për t'u punësuar në vendet perëndimore, nga Kosova janë larguar një numër i madh i infermierëve, konfirmon Imeri nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës. "Më 2023 dokumentacionin për të ikur e kanë marrë 713 [infermierë]", thotë Imeri, duke shtuar se trendi i ikjes së infermierëve vazhdon edhe më tej.

"Gati një infermier në ditë llogaritet se ik për në Gjermani, që i bie rreth më tepër se 300 brenda një viti", thekson ajo.

Imeri, po ashtu, i mbështet pretendimet e Shpresës për nepotizëm gjatë punësimeve në sistemin publik shëndetësor në Kosovë. "Kjo është shumë e vërtetë. Çështja është se [nepotizmi] mbulohet aq mirë me letra [dokumente] sa që e ke të pamundur t'i zbulosh. Ndodh që një infermier është duke pritur 12-13 vjet [për punësim]... Njerëzit janë lodhur duke e pritur, ose duke e lutur politikën që t'i punësojë", thekson Imeri.

Ministria e Shëndetësisë e Kosovës nuk i është përgjigjur pyetjes së "Radios Evropa e Lirë" se a ka plan apo strategji për frenimin e ikjes së punëtorëve shëndetësorë për punësim jashtë vendit si dhe për parandalimin e shkaqeve të

26 VJET NGA MASAKRA NË BURGUN E DUBRAVËS, NDËR AKTET MË ÇNJERËZORE TË REGJIMIT SERB NDAJ SHQIPTARËVE



PRISHTINË, 22 MAJ - Të enjten është shënuar 26-vjetori i masakrës në burgun e Dubravës. Në këtë përvjetorë morën pjesë kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ministra, deputetë, të mbijetuar të kësaj masakre dhe familjarë të të rënëve në këtë masakër.

Fjalë rasti mbajti kryeministri Albin Kurti, i cili tha se ndër aktet më çnjerëzore të regjimit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës, ishte masakra në burgun e Dubravës.

Ndërkaq ministria në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, tha se të burgosurit, të pambrojtur, të shtrënguar pas mureve të larta të një burgu, u shndërruan në shënjestra të një masakre të planifikuar dhe të pamëshirshme. “Rreth 1 000 civilë të pambrojtur u vunë në shënjestër të arsenalit të shumtë të gjuajtjeve të pakontrolluara brenda një hapësire të mbyllur pa shtegdalje, ku prej tyre 117 u vranë dhe rreth 200 u plagosën. Kujtimi i kësaj ngjarje dhe nderimi ndaj viktimave është edhe thirrje për angazhim me

vendosmëri të institucioneve për sjelljen e drejtësisë. Drejtësia për Dubravën është borxh që shteti ua ka viktimave, familjarëve dhe së ardhmes sonë si shoqëri. Sot, në 26 vjetorin e kësaj masakre, përulemi me nderim para kujtimit të të rënëve. Ata janë

zëri që na thërret të mos harrojmë, të mos heshtim dhe të mos ndalemi derisa drejtësia të vihet në vend. Lavdi përjetë viktimave të masakrës së Dubravës! Kujtimi i tyre do të jetë gjithmonë udhërrëfyes i angazhimit tonë për drejtësi”, ka thënë Haxhiu.

Presidentja Vjosa Osmani, duke përkujtuar përvjetorin e masakrës në burgun e Dubravës, tha se Dubrava mbetet plagë e hapur në kujtesën tonë kolektive, por edhe dëshmi e pashlyeshme e brutalitetit të shtetit gjenocidal serb ndaj shqiptarëve të

Kosovës. “Sot kujtojmë me dhimbje masakrën e burgut të Dubravës, një rrënjë prej masakrave më të tmerrshme të kryera nga regjimi gjenocidal i Serbisë gjatë luftës në Kosovë. Në majin e vitit 1999, brenda mureve të burgut të Dubravës ndodhi krimi makabër: për pesë ditë rresht, regjimi gjenocidal i Serbisë, vrau mizorisht 120 të burgosur shqiptarë të luftës dhe të burgosur politik si dhe plagosi 300 të tjerë. Ata u vranë vetëm pse u angazhuan për të drejtën për të jetuar të lirë në tokën e tyre. Në vend që të mbroheshin, u bënë cak i një krimi sistematik, një krimi që sot, 26 vjet më vonë, ende kërkon drejtësi. Dubrava mbetet plagë e hapur në kujtesën tonë kolektive, por edhe dëshmi e pashlyeshme e brutalitetit të shtetit gjenocidal serb ndaj shqiptarëve të Kosovës. Nderim i përjetshëm për të rënë të Dubravës! Drejtësi për viktimat dhe kujtesë historike e përhershme!”, ka thënë Osmani në një deklaratë drejtuar medieve.



pretenduara të kësaj ikjeje.

Cilat janë pasojat?

Oda e Mjekëve e Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës konsiderojnë se autoritetet qeverisëse të vendit duhet të krijojnë një strategji afatgjatë e cila do ta frenonte trendin e largimit të personelit shëndetësor nga vendi. Në të kundërtën, siç thotë Sejdiu, ikja e mjekëve, të cilët janë në fazën e specializimeve, e lë pa kuadro fillimisht mjekësinë primare apo qendrat e mjekësisë familjare. “Sidomos në komunat e mesme dhe të vogla janë një varg shtëpish të shëndetit të cilat janë të mbyllura sepse nuk kanë mjekë. Kjo është vala e parë. Vala e dytë do të thotë se tashmë vetëm se kanë nisur të goditen spitalet

rajonale, ku nuk ka ripërtëritje [me mjekë]. Vala e tretë do ta godasë Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), por pak më vonë”, thekson Sejdiu. Ai shton se në QKUK, në Prishtinë, janë të koncentruar shumica e mjekëve të profileve të ndryshme. Kjo qasje, siç pretendon ai, shfaq mungesën e një strategjie të punësimit nga Ministria e Shëndetësisë, e cila do të duhej t'i shpërndante kuadrot në mënyrë proporcionale nëpër rajonet e tjera të Kosovës. Edhe Imeri shpreh mendimin se, në rast se nuk frenohet trendi i ikjes së personelit shëndetësor jashtë vendit, goditjen më të madhe do ta marrë mjekësia primare. “Kordinatorët me të cilët kam kontakt të përhershëm thonë se në vitin 2030 nuk do të mbetet asnjë mjek familjar”, thotë Imeri. Ajo shton se është e

domosdoshme që autoritetet kompetente qeverisëse të krijojnë politika të qëndrueshme shëndetësore dhe strategji që eliminojnë shkaqet e ikjes së personelit shëndetësor jashtë vendit. Në rast se kjo nuk ndodh, sipas saj, e ardhmja e sektorit shëndetësor publik është krejtësisht e pasigurt. “Në njëfarë forme të krijohet një pasiguri, për çka edhe unë, në këtë moshë në të cilën jam [50 vjeç], shpeshherë do të mendoja të ikja... mbase, t'i marr fëmijët dhe të ik. Në qoftë se do ta krijoja një vend pune, sot do të nënshkruaja dhe do të ikja”, përfundon Imeri. Shpresa është e mendimit që gjithsecili mendon që karrierën dhe të ardhmen e vet ta vazhdojë në vendin ku është lindur, është rritur dhe është zhvilluar. “Fatkeqësisht, nëse kushtet janë të njëjta [në

Mbi 100 mijë qytetarë u larguan nga Kosova për tri vjet

Të dhënat nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) tregojnë se vetëm brenda tre vjetësh, nga fillimi i vitit 2021 e deri në fund të 2023-s, nga Kosova janë larguar 105 525 qytetarë. Në vitin 2021 janë larguar 42 728 qytetarë, 41 553 në vitin 2022 dhe 21 244 në vitin 2023.

Nga 1 janari i vitit 2024 ka hyrë në fuqi vendimi për liberalizimin e vizave në zonën Shengen dhe qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë pa viza në 27 shtete evropiane. Të dhënat për numrin e qytetarëve të Kosovës që janë larguar nga vendi gjatë vitit 2024, sipas ASK-së, do të publikohen gjatë muajit qershor të këtij viti.

Kosovë], atëherë karriera ime dhe jeta ime vazhdojnë në Gjermani ose Zvicër. Në momentin që në Kosovë bëhet mirë dhe po shpresoj që bëhet

mirë - unë patjetër do të jem këtu që ta jap maksimumin për të kontribuar për vendin tim, për atdheun tim dhe për njerëzit e mi të dashur”.

Rahovec, përfundon dëgjimi buxhetor me drejtues shkollash dhe staf mbështetës

RAHOVEC, 22 MAJ - Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Rahovec, Afrim Limani, ka paraqitur limitet buxhetore bazuar në qarkoren e parë buxhetore, po ashtu ka përmendur që dëgjimet e

hershme si këto ndihmojnë që nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të jenë më të qarta dhe më të drejtpërdrejta, edhe të përfshihen në planifikimin e hershëm buxhetor për vitin 2026.

Komuna e Rahovecit ka njoftuar se të gjitha kërkesat shënohen nga grupi punues dhe, sipas mundësive buxhetore, do të përfshihen në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2026.



U NDALOHET LINJA NDËRKOMBËTARE DISA AUTOBUSËVE PASI NUK E KISHIN KRYER KONTROLLIN TEKNIK GJASHTËMUJOR

GJILAN, 22 MAJ - Më 21 dhe 22 maj njësitë rajonale të komunikacionit rrugor në Gjilan, në kuadër të aktiviteteve të vazhdueshme për garantimin e sigurisë në trafikun rrugor, kanë realizuar kontrole të shtuara në mjetet e operatorëve vendorë të transportit publik ndërkombëtar të udhëtarëve nga Republika e Kosovës për në linjat ndërkombëtare. Gjatë kontrolleve të realizuara në pika të ndryshme të kontrollit janë ndaluar disa autobusë të këtyre linjave dhe, pas verifikimit të

dokumentacionit të nevojshëm, është konstatuar se disa prej tyre kanë qarkulluar në rrugë pa e kryer kontrollin teknik periodik gjashtëmuor, që është obligim ligjor i përcaktuar me Ligjin për Automjetet nr. 05/L-132 në Republikën e Kosovës. Si rezultat, njësitë policore të njësisë së komunikacionit rrugor në Gjilan kanë shqiptuar pesë gjopa ndaj personave juridikë, përfaqësues të kompanive të transportit, si dhe pesë gjopa ndaj personave fizikë (drejtuesve të mjeteve të

transportit të udhëtarëve) të përfshirë në këtë veprimtari në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjilan u bënë thirrje të gjithë operatorëve të transportit publik të udhëtarëve, veçanërisht atyre që veprojnë në linjat ndërkombëtare, t'i respektojnë me përpikëri obligimet ligjore për të siguruar një qarkullim të sigurt dhe të përgjegjshëm në rrugë. "Siguria e qytetarëve është prioriteti ynë i përbashkët", ka njoftuar Policia e Kosovës.



HAMZA TAKON AMBASADORIN BRITANIK, BISEDOJNË PËR KRIJIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA



MITROVICË, 22 MAJ - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër dhe kryetar i Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në vendin tonë, Jonathan Hargreaves. Hamza ka bërë me dije se me ambasadorin britanik ka biseduar për nevojën e krijimit të institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 9 shkurtit.

"Sot e pritja ambasadorin britanik Jonathan Hargreaves, me të cilën bisedova për nevojën e krijimit të institucioneve të reja në nivelin qendror dhe për zhvillimet politike në vendin tonë. Britania e Madhe është partnere strategjike e Kosovës dhe i jemi shumë mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme të saj", ka shkruar Hamza në "Facebook".

VENGU NË TAKIM ME JASHARIN: KOSOVËN DO TA BËJMË PJESË TË PLOTË TË ARKITEKTURËS SË SIGURISË EUROATLANTIKE

TIRANË, 22 MAJ - Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, ka zhvilluar në Tiranë një takim me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtnant Bashkim Jashari. "Bashkë me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA - gjenerallejtnant Arben Kingji, prita sot komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Bashkim Jashari.

Bashkëpunimi strategjik dhe vëllazëror mes dy Forcave tona vijon të thellohet: nga trajnimi dhe arsimi ushtarak, te zhvillimi i industrisë së mbrojtjes, pjesëmarrja në stërvitje dhe përpjekjet e përbashkëta në nismat rajonale. Së bashku do të punojmë për ta bërë Kosovën pjesë të plotë të arkitekturës së sigurisë euroatlantike", ka shkruar në "Facebook" Vengo.



Operacion kundër terrorizmit në Fushë-Kosovë dhe Malishevë, arrestohen dy persona

FUSHË-KOSOVË, 22 MAJ - Dy persona të dyshuar për nxitje të përçarjes dhe mosdurimit dhe për shpërndarje të ideologjisë për organizata terroriste përmes rrjeteve sociale janë arrestuar të enjten në Kosovë, ka njoftuar

policia. Sipas Policisë së Kosovës, në orët e hershme të 22 majit është realizuar "një operacion i suksesshëm policor", pas hetimeve nga Drejtoria Kundër Terrorizmit e Policisë, në koordinim me

Prokurorinë Speciale të Kosovës. Operacioni policor ka përfshirë dy raste të ndara, ku janë kryer tri kontrole në vendbanime në Fushë-Kosovë dhe në Malishevë dhe ku janë arrestuar të dyshuarit.

Identiteti i të dyshuarve nuk është treguar. Hollësi të mëtejshme, po ashtu, nuk janë dhënë. Policia ka thënë se "të gjitha veprimet e mëtejme do të ndërmerren në bashkëpunim me organet e drejtësisë".



GLPS THOTË SE 30 VENDIME TË QEVERISË NË LARGIM JANË TË KUNDËRLIGJSHME

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MAJ - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka njoftuar se është duke ndjekur në vazhdimësi zhvillimet politike nga 9 shkurti 2025 - dita e zgjedhjeve, certifikimi i rezultateve, dorëheqjet e zyrtarëve të kabinetit qeveritar të zgjedhur deputetë dhe miratimit të raportit për verifikimin e mandateve nga Kuvendi i Kosovës më 19 prill. Duke u rezervuar mbi kushtetutshmërinë e dispozitave të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës që rregullojnë situatat, kompetencat e kufizimet kur qeveria konsiderohet në detyrë apo në largim, bazuar në këtë ligj që është aktualisht në fuqi, janë analizuar vendimet e ekzekutivit në largim që janë marrë në 10 mbledhjet e mbajtura nga dita e zgjedhjeve e deri më tani. “Me shpërbërjen e Kuvendit dhe mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme në vendin tonë më 9 shkurt 2025, Qeveria Kurti 2 ka kaluar si qeveri në largim konform nenit 28, par.1.4 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës, kurse kufizimet për detyrat dhe përgjegjësitë e saj deri në zgjedhjen e Qeverisë së re nga Kuvendi janë përcaktuar në nenin 31 të këtij Ligji. Nga data 9 shkurt 2025 (dita e zgjedhjeve) e deri më 27 mars 2025 (dita e certifikimit të rezultateve nga

KQZ), Qeveria në largim ka mbajtur 7 mbledhje dhe ka marrë 76 vendime. Marrë parasysh kufizimet që i njeh Ligji në situatat kur kemi të bëjmë me qeveri në largim, GLPS vlerëson se 13 nga këto vendime janë të kundërligjshme për shkak se janë marrë duke i tejkaluar kufizimet në kuadër të nenit 31 të Ligjit për Qeverinë. Kurse, vendimet e tjera janë në kuadër të punëve të përditshme dhe për shkak të vijueshmërisë normale të veprimtarisë ekzekutive”, është thënë në njoftimin e GLPS-së. Vendimet e kundërligjshme i përkasin natyrës së inicimit të procedurave të reja për emërimin në pozitat publike, për emërimin e të cilave është kompetente në bazë të ligjeve, duke mos u kufizuar në theelimin e komisioneve ad-hoc për pozitat: kryeinspektor shëndetësor në Inspektoratin Shëndetësor; drejtor i përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, drejtor i përgjithshëm i Institutit të Kosovës për Administratë Publike, drejtor ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit Civil, drejtor i përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit, drejtor ekzekutiv i Agjencisë për Siguri Kibernetike dhe drejtor ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë. Po ashtu, GLPS të kundërligjshme i konsideron



edhe vendimet me të cilat qeveria në largim, pavarësisht prej kufizimeve, i ka marrë lidhur me miratimin e koncept-dokumenteve dhe strategjive, të tilla si: Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme - NFH (early childhood intervention-eci) 2025-2030, Koncept-dokumenti për Shëndetin e Bimëve, Koncept-dokumenti për Bujqësi Organike etj. Ndërsa duke qenë se nga data 27 mars 2025, kur në kundërshtim me Kushtetutën,

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ka certifikuar zyrtarët me post ekzekutiv si deputetë të legjislaturës IX, ata, duke shfrytëzuar mandatin kundërkushtetues si zyrtarë me post ekzekutiv, njëkohësisht të certifikuar si deputetë, kanë marrë pjesë dhe kanë votuar në tri mbledhjet e radhës të ekzekutivit. “Në këto takime janë marrë gjithsej 17 vendime nga një kabinet qeveritar i cili në përbërje ka pasur kryeministër e ministra që në kundërshtim me nenin 72 të Kushtetutës, kanë prezantuar dhe kanë qenë pjesë

e vendimmarrjes. Rrjedhimisht, kjo nënkupton që secili nga këto vendime është i kundërligjshëm sepse është marrë nga një përbërje e Ekzekutivit në kundërshtim me aktin më të lartë juridik”, ka njoftuar GLPS. Në këtë situatë me përbërjen e këtij kabinetit qeveritar, GLPS rekomandon që mos të merren më vendime të cilat bien ndesh me ligjin dhe Kushtetutën e Kosovës. Bazuar në kufizimet e kësaj përbërjeje, GLPS rekomandon që secili vendim i radhës të merret në një përbërje legjitime.

IKD-ja MIRËPRET REFORMËN NË SISTEMIN PROKURORIAL, KËRKON NGA KPK TË MOS NDËRMARRË VEPRIME QË MINOJNË KËTË REFORMË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 MAJ - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka mirëpritur shpalljen e Ligjit nr. 08/L-249 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial (Ligji i ri). IKD-ja thekson se publikimi i ligjit të ri, i cili tanimë ka kaluar testin e kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese, paraqet fillimin e jetësimit të reformës më se të domosdoshme në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), e cila reformë qëllim parësor ka eliminimin e korporatizmit brenda sistemit prokurorial, korporatizëm i konstatuar nga Komisioni i Venecias. Ndër të tjera, ky ligj parashikon që përbërja e KPK-së nga 13 anëtarë sa është aktualisht, të shkurtrohet në shtatë anëtarë. Shkurtimi do të bëhet në mënyrë graduale, duke respektuar mandatin e mbetur të anëtarëve



aktualë. “Po ashtu, ligji i ri parasheh edhe ndalesën e avancimit të anëtarëve të KPK-së në një periudhë kohore prej dy vjetësh pas përfundimit të mandatit, nëse mundësitë e avancimit në sistemin prokurorial janë krijuar si rezultat i vendimeve në të cilat ata kanë marrë pjesë si anëtarë të Këshillit. Angazhimi dhe

përkushtimi i KPK-së për zbatimin e ligjit të ri mbetet i rëndësishëm së veçantë duke respektuar dhe zbatuar risitë e reja në të. IKD-ja kërkon dhe pret nga KPK të mos lejojë në asnjë rrethanë që për interesa të ngushta të anëtarëve aktualë, apo anëtarëve që kanë ofruar dorëheqje, të shkelen dhe cenohen parimet e përcaktuara

në ligjin e ri të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe që ka kaluar filtrin e Gjykatës Kushtetuese”, thuhet në reagim. IKD-ja tutje thekson se Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të dëshmojë integritet dhe vendosmëri duke mos lejuar në asnjë rrethanë që anëtarë të saj të caktuar, përmes ofrimit të dorëheqjes, të zëvendësohen me anëtarë të rinj ose duke i avancuar apo transferuar në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës me procedura të shpejta. “Deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri, çdo veprim në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e këtij ligji do të mund të perceptohej si tentativë për ta sabotuar reformën në sistemin prokurorial dhe minuar zbatimin e ligjit duke ruajtur praktikën e përbërjes korporatiste. Ky ligj tashmë ka kaluar testin e kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese dhe nuk ekziston asnjë arsye legjitime për të vepruar në kundërshtim me të. Duke mos paragjykuar

përkushtimin e KPK-së për zbatimin e ligjit të ri, IKD vlerëson se dorëheqja e anëtarit të saj, Armend Zenelaj, vetëm pak muaj para përfundimit të mandatit të rregullt, krijon dyshime se kemi të bëjmë me dorëheqje të koordinuar, të cilat tentojnë ta sabotojnë reformën në sistemin prokurorial”, thuhet në reagim. Përkundër faktit se ligji i ri hyn në fuqi pas 15 ditëve, Zenelaj nuk duhet të zëvendësohet me ndonjë anëtar të ri, në atë mënyrë që numri i anëtarëve të KPK-së të zvogëlohet gradualisht, ashtu siç parashihet me ligjin e ri. Sipas IKD-së, përgjatë periudhës dyvjeçare KPK nuk duhet të avancojë Zenelajn e as ndonjë anëtar tjetër që jep dorëheqje, sepse dorëheqjet eventuale të ofruara gjatë kësaj faze deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri do të mund të perceptoheshin si tentativë e KPK-së për t'i zgatur mandatet sipas përbërjes korporatiste.

BQK-ja, PJESËMARRËSE NË ‘KOSOVA FINANCE FORUM 2025’: DISKUTOHEN TEMA MBI STABILITETIN FINANCIAR, INOVACIONIN TEKNOLOGJIK DHE BASHKËPUNIMIN RAJONAL

PRISHTINË, 22 MAJ - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) mori pjesë në “Kosova Finance Forum 2025” si partner institucional duke e organizuar panelin e nivelit të lartë rajonal për temën e stabilitetit financiar si dhe bashkëpunimin rajonal, si dhe u përfaqësua në nivele të ndryshme në panele e grupe punuese, të organizuara në këtë forum në tema të fushëveprimit të BQK-së. Në fjalën hyrëse drejtuar të pranishmëve, guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, përshëndeti forumin duke e vlerësuar si një nisim dhe platformë të re të rëndësishme për dialog të hapur dhe konstruktiv mbi të ardhmen financiare.

Stabiliteti financiar, gjithëpërfshirja financiare, inovacioni teknologjik dhe bashkëpunimi rajonal janë shtylla të rëndësishme për ndërtimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme ekonomike, ka theksuar guvernatori Ismaili, ndërsa ka folur për rëndësinë e ndërmarrjes së reformave të thella strukturore për t'i përballuar sfidat aktuale. Guvernatori Ismaili më tutje u shpreh se stabiliteti financiar mbetet objektivi themelor për të gjitha bankat qendrore të rajoni, veçanërisht në një mjedis të karakterizuar nga pasiguri gjeopolitike, presione inflacionare si dhe shtrengim monetar në tregjet globale, në një kohë ku rreziqet



jotradicionale janë në rritje nga ato klimatike e deri te siguria kibernetike. BQK-ja organizoi panelin e

nivelit të lartë rajonal me temën “Stabiliteti financiar, sfidat për bankat qendrore dhe bashkëpunimi rajonal”, ku

pjesëmarrës ishin zëvendës guvernatorët dhe drejtues të lartë të bankave qendrore nga rajoni, ku diskutimi është fokusuar në përforcimin e qëndrueshmërisë makroekonomike, përballimin e sfidave të përbashkëta dhe avancimin e koordinimit ndërinstitucional në rajon. BQK në këtë forum mori pjesë në kuadër të rolit proaktiv në nxitjen e dialogut profesional dhe në promovimin e bashkëpunimit për ndërtimin e sistemeve financiare më të qëndrueshme, të sigurt dhe më të integruara në rajon, në pajtim me objektivin e 4-t të Planit Strategjik të BQK-së, për qasje të hapur ndaj nismave të shoqërisë civile, organizatave apo forumeve profesionale.

BQK-ja VLERËSOHET PËR AVANCIMIN E REFORMAVE INSTITUCIONALE, ZHVILLIMIN E SEKTORIT FINANCIAR DHE FORCIMIN E QËNDRUESHMËRISË

PRISHTINË, 22 MAJ - Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka miratuar rishikimin IV të Marrëveshjes Stand-By (SBA) dhe Programit për Rezilencë dhe Qëndrueshmëri (RSF), duke konstatuar përfundimin me sukses të objektivave të të dy programeve, mbi bazën e performancës së fortë të dëshmuar dhe vlerësuar. Në njoftimin e FMN-së, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) po udhëheq me përkushtim zbatimin e reformave të rëndësishme për përmirësimin e qeverisjes dhe cilësisë institucionale, zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar dhe forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike të vendit. Raporti i publikuar lidhur me



këtë rishikim thekson se BQK-ja ka bërë përparim të rëndësishëm në forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit financiar. BQK-ja ka rishikuar Rregulloren e Punës të Bordit të saj, ka zbatuar riorganizimin e brendshëm, ka miratuar planin trevjeçar për zbatimin e Procesit të Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës (SREP) për ta

përmirësuar mbikëqyrjen bankare dhe ka përmirësuar kërkesat për raportimin e të dhënave për regjistrin e kredive. Për më tepër, Ligji për Bankat, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në dhjetor të 2024-s, por më pas i kontestuar në procedurë në Gjykatën Kushtetuese, do të ndihmojë në përmirësimin e kriterëve të licencimit dhe qeverisjes korporative, forcimin e kompetencave mbikëqyrëse të BQK-së dhe fuqizimin e mekanizmave për përmbylljen e bankave që përballen me sfida për ta ushtruar aktivitetin e tyre. Më tutje, FMN-ja thekson se reformat në vijim do të ndihmojnë në forcimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes financiare, mbikëqyrjes së

rezikut sistematik, gatishmërisë për përballimin e krizave dhe proceseve dhe mekanizmave institucionale, me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë financiare. “Sektori bankar vazhdon të zgjerohet me shpejtësi duke ofruar mbështetje thelbësore për aktivitetin ekonomik, ndërsa ruan një nivel të lartë të kapitalizimit, likuiditetit dhe profitabilitetit. Bankat janë të përgatitura për t'i përmbushur kërkesat e reja rregullative të kapitalit pas miratimit të masave makroprudenciale në shtator 2024. Këto instrumente ndihmojnë për krijimin e shtesave mbrojtëse, përfshirë përmes shtimit të kapitalit apo emetimit të borxhit të varur”, thuhet në raportin e FMN-së. Banka Qendrore e Republikës

së Kosovës ka bërë hapa të rëndësishëm drejt integritimit në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA) dhe zhvillimit të sistemit rajonal të pagesave të shpejta (TIPS Clone). Gjithashtu, FMN-ja ka vlerësuar se iniciativat e fundit, përfshirë llogarinë bankare me shërbime bazë (pa tarifa) dhe platformën online për krahasimin e produkteve dhe shërbimeve financiare, kanë sjellë përfitime për konsumatorët, duke rritur konkurrencën dhe edukimin financiar. BQK-ja falënderon FMN-në për bashkëpunimin dhe partneritetin strategjik, ndërsa mbetet e përkushtuar për rolin e saj si garantuese e stabilitetit financiar dhe mbështetëse e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

AKB-ja: PROTESTAT JANË TË PASHMANGSHME, NUK MUND TA PRANOJMË KËTË PADREJTËSI ENERGJETIKE

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 MAJ - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka mbajtur takimin e rregullt të Bordit udhëheqës, ku është trajtuar me shqetësim të thellë vendimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji për t'i detyruar rreth 1 300 biznese që nga 1 qershori 2025 të dalin nga furnizuesi universal, si dhe rritja e çmimit të energjisë elektrike për 16.10 %. Sipas AKB-së, ky vendim është i papranueshëm, i njëanshëm dhe godet rëndë sektorin privat, sidomos prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve vendore, të cilët

tashmë po përballen me sfida të mëdha financiare dhe treg të pasigurt. Nga ky takim u tha se rreth 50 milionë euro shtesë në vit do të paguhet nga bizneset vetëm për energji, kosto që përfundimisht bie mbi qytetarët e Kosovës përmes rritjes së çmimeve dhe humbjes së vendeve të punës. AKB-ja në këtë takim ka kërkuar shtyrjen urgjente për të paktën një vit të këtij vendimi, përfshirjen e bizneseve në konsultimet vendimmarrëse dhe rishikimin e menjëhershëm të tarifave dhe kushteve të tregut të hapur energjetik. “Nëse kërkesat tona injorohen, AKB-ja do të

mund të ndërmarrë masa demokratike dhe të vendosura protestuese, duke përfshirë protesta të organizuara me punëtorë dhe mjete pune në rrugët kryesore të Kosovës, mbyllje të përkohshme të bizneseve dhe shprehje të pakënaqësisë në sheshe dhe para institucioneve. Nuk do të mund të lejojmë që politika e energjisë të bëhet barrë për ekonominë vendore dhe konsumatorin e zakonshëm”, ishte konstatim i Bordit udhëheqës të AKB-së. AKB-ja ka theksuar se si institucion janë të vendosur ta mbrojnë interesin e bizneseve



dhe të qytetarëve të Kosovës. Të pranishëm në këtë takim ishin kryetari i AKB-së, Agim Shahini, Xhevdet Rexhepi ‘Viva Fresh Store’, Haziz Tafaj

‘Agrokosova Holiding’, Shkëlzen Jusaj ‘Petrol Company’, Arianit Koci ‘Koci&Vokshi’, Isaku Tusha ‘IMI COP’ dhe Ahmet Kuqi ‘Solid’.

A PO AFROHET NJË LUFTË E TRETË BOTËRORE?

Rendi botëror i bazuar në rregulla është në tërheqje dhe dhuna është në rritje, duke detyruar vendet të rishikojnë marrëdhëniet e tyre.



Nga Patrick WINTOUR

Dy javë pasi ish-aleatët, në një botë gjithnjë e më e ndarë, përkujtuan veçmas 80-vjetorin e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në Evropë, ndjesia e një rrëshqitjeje të pandalshme drejt një Luftë të Tretë Botërore po bëhet gjithnjë e më e prekshme.

Shpërbërja e Pax Americana, ndërlidhja e konflikteve, gatishmëria e re për të përdorur dhunën shtetërore të sponsorizuar dhe mosfunksionimi i institucioneve të rendit botëror të bazuar në rregulla janë të gjitha dëshmi të një epoke brutaliteti. Nga Kashmiri te Khan Younis, nga Hodeidah te Port Sudani e Kursku, i vetmi zë është ai i shpërthimeve – dhe i vetmi mësim është se rregullat e vjetra nuk vlejnë më.

Politikania dhe këshilltarja britanike Fiona Hill, e angazhuar në rishikimin strategjik të mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, argumenton se Lufta e Tretë Botërore ka nisur tashmë – vetëm se ne nuk e kemi kuptuar ende.

Frika nga një botë ku askush

nuk është më në kontroll – për shkak të shkencës apo globalizimit – nuk është e re. Kjo ishte tema e dy ligjëratave Reith: njëra më 1967 nga antropologu Edmund Leach, dhe tjetra më 1999 nga filozofi politik Anthony Giddens. Por rrallëherë ka qenë më e qartë se rendi botëror i krijuar në vitin 1945 është në sprapsje të shpejtë.

Ish-ministri i jashtëm laburist David Miliband e përmbloodhi qartë javën e kaluar në një fjalim në Chatham House, kur tha: “E di që njerëzit gjithmonë thonë se bota po ndryshon, por ky duket si një moment i vërtetë tronditjeje gjeopolitike – po aq domethënës sa 1989-90, kur bota kaloi nga Lufta e Ftohtë në një rend unipolar. Për mua, administrata Trump ishte si simptomë ashtu edhe shkak i këtyre ndryshimeve. Problemi është se është shumë më e qartë se nga çfarë po largohemi – nga një botë ku SHBA ishte një qendër të sistemit global – por nuk është e qartë ku po shkojmë. Shumë flasin për një botë shumëpolare që pasqyron një rishpërndarje të fuqive, por ajo ide më duket shumë e qetë,

shumë e sigurt për një realitet që është shumë më i trazuar.”

Ish-mentori i tij, Tony Blair, në një fjalim në Kaliforni tha: “Të gjithë janë nxjerrë nga zona e tyre e rehatisë. Zhurma që dëgjoni nga politika është paniku për të gjetur mundësi të reja. Njerëzit po rishikojnë pozicionin e tyre në botë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo është, pa dyshim, tronditja më e madhe gjeostrategjike që mbaj mend në raport me Amerikën dhe botën.”

Sipas ish-sekretarit amerikan të shtetit Antony Blinken, mosinteresi i Donald Trump për të ruajtur aleancat është një “akt vandalizmi.” Ai tha se diplomatët nëpër botë po pyesnin: “Çfarë dreguin po ndodh?”

Blinken tha se Amerika ka harxhuar 80 vite duke ndërtuar besim, partneritete të forta ekonomike dhe aleanca ushtarake e politike – dhe nëse e gjitha kjo u shkatërrua brenda 100 ditësh, do të ishte jashtëzakonisht e vështirë të rindërtohej.

“Kjo do të thotë që vendet po kërkojnë mënyra për të bashkëpunuar mes tyre, duke anashkaluar SHBA-në,” tha ai.

“Ideja që çfarë thuhet sot do të përmbysset nesër, dhe më pas do të ndryshohet sërish, do të thotë që nuk mund të mbështeten më te Amerika. Joe Biden dikur thoshte se nuk është kurrë ide e mirë të vësh bast kundër Amerikës. Problemi sot është që njerëzit nuk vënë më bast për Amerikën.”

Pasoja e zymta të tërheqjes së Amerikës janë bërë të dukshme gjatë javëve të fundit. Ndoshta nuk jemi në një luftë botërore, por bota është në luftë.

Në Gaza, bota ka qenë dëshmitare e një bllokade mbi ushqimin, ndihmën dhe furnizimet mjekësore, në kundërshtim me urdhrat detyrues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ), që ka hyrë në muajin e tretë.

Izraeli, në kërkim të sigurisë, ka bombarduar gjatë muajit të fundit Jemenin, Libanin, Sirinë dhe Gazën. Çdo ditë, ai i kërkon SHBA-së leje për të bombarduar Iranin.

Ish-presidenti Donald Trump ka pak të drejtë të ankohet, kur Bezalel Smotrich, ministri ultra-i-djathtë i Financave i Izraelit,

ndau të martën e kaluar vizionin e tij për Rripin e Gazës, duke parashikuar që brenda gjashtë muajve, popullsia e atij territori do të shtrëngohet vetëm në një zonë të ngushtë, ndërsa pjesa tjetër “do të shkatërrohet plotësisht.”

Smotrich thjesht po përsëriste një version të planit të Trumpit për ta zbratur Gazën nga palestinezët, një plan krejtësisht në kundërshtim me kushtet e armëpushimit të cilat kishte negociuar i dërguari i tij. Në një fjalim gjatë një “konference për vendbanimet”, Smotrich deklaroi gjithashtu se Izraeli do të “zbatojë sovranitetin” mbi Bregun Perëndimor brenda mandatit të qeverisë aktuale, që përfundon në tetor 2026. “Brenda disa muajsh, do të mund të themi se kemi fituar. Gaza do të shkatërrohet plotësisht,” tha Smotrich. “Pas gjashtë muajsh, Hamas nuk do të ekzistojë më si ent funksional.”

Me Trumpin që heshti, u takoi evropianëve të përgjigjen. “Ka ardhur koha që Bashkimi Europian dhe e gjithë bashkësia ndërkombëtare të zgjohet,” tha ministri i jashtëm belg Maxime

Prévot, duke e quajtur bllokadën një “turp absolut.”

“Nuk është e pranueshme që të ndalosh me qëllim ndihmën humanitare, qasjen në ushqim, kujdes shëndetësor, ujë, energji elektrike – si strategji lufte. Kjo është krejtësisht e papranueshme.”

Presidenti francez Emmanuel Macron deklaroi: “Nëse dënojmë Rusinë për shkeljen e sovranitetit të Ukrainës, nuk mund të rrimë në heshtje kur ndodh e njëjta në Gaza. Hamas duhet të luftohet, po, por jo në kurriz të shkeljes së çdo rregulli.”

Ai kërkoi një reagim nga Evropa, por në një takim të ministrave të jashtëm në Poloni, 27 ministrat nuk arritën të bien dakord as për një deklaratë të përbashkët, e lëre më për të ndërmarrë veprime të përbashkëta si pezullimi i marrëveshjes së tregtisë së lirë me Izraelin – një propozim holandez.

Ndërkohë, në Port Sudan, rruga kryesore për ndihmën humanitare në Sudan, Forcat e Mbështetjes së Shpejtë (RSF) shkatërruan infrastrukturën me drone, njësoj siç bombardimet izraelite kanë shkatërruar Hodeidahun, pika kryesore e hyrjes së ndihmave në Jemen.

Më 5 maj, një përpjekje e qeverisë sudaneze për të bërë përgjegjëse Emiratet e Bashkuara Arabe në Gjykatën Ndërkombëtare për drejtimin e armëve drejt RSF-së dështoi. EBA, si shumë shtete të tjera, është nënshkruese e Konventës për Gjenocidin, por ka vendosur një rezervë ligjore që thotë se respektimi i konventës prej saj, nuk është subjekt i gjykimit në ICJ.

Gjykata pranoi me ngurrim se kishte mungesë të qartë juridiksioni. Vetëm një gjykatës – Abdulqawi Ahmed Yusuf nga Somalia – votoi kundër.

Kështu, Emiratet e Bashkuara Arabe dalin me imazh pozitiv si vend që e ka nënshkruar kon-

ventën, por nuk do të gjykojen për respektimin e saj.

I është lënë Sekretarit të Jashtëm të Mbretërisë së Bashkuar, David Lammy të bindë palët për një armëpushim, por deri tani pa sukses. SHBA-të, nga ana tjetër, e cilësojnë udhëheqjen e RSF-së si gjenocidale, por nuk ndërmarrin veprime konkrete diplomatike.

Në Kashmir, ku dy shtete me armë bërthamore javën e kaluar godisnin me raketa avionët e njëri-tjetrit, SHBA-të duket se ndërmjetësuan një armëpushim. Mbetet për t’u parë nëse marrëveshja, e ndërmjetësuar nga sekretari i shtetit amerikan Marco Rubio dhe nënkryetari JD Vance, do të mbajë – një kthesë e fortë nga qëndrimi i Vance 48 orë më parë, kur kishte thënë se SHBA nuk do të ndërhynte në konfliktin Indi-Pakistan sepse është “jashtë interesave tona.”

Në përplasjet e mëparshme mes Indisë dhe Pakistanit, ndërhyrja e SHBA-ve ka qenë vendimtare për të ulur tensionet nga të dyja palët.

Në korrik 1999, në Uashington, Bill Clinton e detyroi liderin e Pakistanit Nawaz Sharif të tërhiqej, në atë që një zyrtar e përshkroi si takimi më i rëndësishëm i presidencës Clinton me një lider të huaj. Ish-sekretari i shtetit Mike Pompeo zbuloi në kujtimet e tij sa shumë i ishin afruar dy shtetet një konflikti bërthamor në shkurt 2019, diçka që ai e pengoi nga një dhomë hoteli në Hanoi.

India javën e kaluar nuk e paraqiti konfliktin si akt terrorist, por si përplasje mes dy shteteve, duke deklaruar se problemi thelbësor është që “Pakistan veptron si mburojë për terrorizmin.”

Këto konflikte mund të duken të shkëputura nga njëri-tjetri, përveçse kur flitet për një temë të përbashkët: mungesa e udhëheqjes amerikane dhe paqëndrueshmëria e përher-

shme.

Por në Ukrainë, sipas Fiona Hill, elementët strukturorë të një lufte botërore po bashkohen. Numri i viktimave mund të jetë ndryshe nga ai i Luftës së Dytë Botërore, por sipas ushtrisë britanike, Rusia ka pësuar rreth 900.000 viktima, shumë më tepër sesa në luftërat e saj në Çeçeni dhe Afganistan.

Për më tepër, këto luftëra janë, sipas Hill, “konflikte që ndryshojnë sistemin, me shumë vende të përfshira në mënyra të ndryshme.”

Peshkarexha me flamur kinez dhe ekuipazh rus që shkatërrojnë kablo nënujore në Detin Baltik, janë vetëm një pjesë e luftës globale të Vladimir Putinit.

Kina, Koreja e Veriut dhe Irani janë të gjitha në mbështetje të Rosisë, disa në mënyra më materiale, si ndërtimi i fabrikave të dronëve apo dërgimi i ushtarëve.

Shumë shtete të tjera kanë qenë të gatshme ta mbajnë ekonomikisht në këmbë Rusinë, në mënyra që vënë në pikëpyetje neutralitetin e tyre. India, me të cilën Britania përfundoi një marrëveshje tregtie javën e kaluar, ka blerë 125 miliardë dollarë naftë nga Rusia që nga fillimi i luftës, si dhe armë ruse.

Konflikti është paraqitur nga Rusia dhe aleatët e saj si një luftë kundër hegjemonisë amerikane. Trump kishte një plan për të larguar SHBA nga vijat e zjarrit dhe për të vendosur marrëdhëniet me Rusinë mbi një bazë të re, një dëshirë që ai e ka ushqyer që nga vitet 1980.

Ai e sheh botën në mënyrë të ngjashme me Putinin – disa fuqi sovraane që ndajnë botën në zona influence. Ëndrra e tij është të rindezë Konferencën e Jaltës të vitit 1945, së bashku me Putinin dhe ndoshta Xi Jinping, me Evropën si spektatore dhe Ukrainën e copëtuar. Por organizimi i një tradhtie të tillë ka

rezultuar më i vështirë se sa pritej.

Në Shtëpinë e Bardhë, Trumpi i tha Zelenskyt: “Duhet të jesh mirënjohës. Nuk ke asnjë kartë në dorë.”

Por Trumpi luajti me kartat që kishte – shumë prej të cilave i hodhi poshtë me politikë e tij doganore vetëshkatërruese. Ndërkohë, doli se Zelensky kishte disa karta, të cilat i përdori me zgjuars: duke ofruar një armëpushim 30-ditor, një marrëveshje për mineralet me SHBA-në dhe duke e vendosur nga shefi i stafit të Zelenskyt, Andriy Yermak) kishte aromë pajtimi, por ushqente ego-n e Trump.

Një ndryshim humori në Uashington është i dallueshëm. Edhe Vance, që dikur ishte kritikuesi më i ashpër i Zelenskyt, pranoi javën e kaluar se Rusia “po kërkon shumë” dhe se Evropa dhe SHBA tani janë “në të njëjtën skuadër.” Liderët evropianë do ta mirëprisnin këtë, por tani është e qartë në të gjithë Evropën – jo vetëm në Paris – se pavarësisht sigurisë që jep Vance, Evropa duhet të jetë e aftë të veprojë në mënyrë të pavarur nga SHBA.

Trump është qartësisht i pabesueshëm, dhe vlerësimi i tij i butë për qëllimet e Putinit nuk ndahet nga të tjerët. Ka nisur tashmë planifikimi për një forcë sigurie evropiane në Ukrainë, ashtu sikurse edhe planifikimi për një sulm të mundshëm rus ndaj Evropës. Që nga shkurti, Franca dhe Britania, përmes një force të përbashkët, kanë formuar bërthamën e këtij planifikimi. Por tashmë kjo përfshirje është zgjeruar, me drejtues politikë të rinj që vijnë nga katër vendet e grupit Weimar+: Polonia, Franca, Gjermania dhe Britania e Madhe.

Liderët e Britanisë, Francës, Gjermanisë dhe Polonisë për herë

të parë shkuan së bashku në Kiev këtë fundjavë për të forcuar thirrjen për një armëpushim 30-ditor, që sipas tyre duhej të niste të hënën.

Por një postim në rrjetet sociale nga Trump, ku këmbëngulte që Ukraina duhet të niste menjëherë bisedimet për paqe me Rusinë, i prishi – dhe ndoshta rrezikoi – planet e kujdesshme të vendosura për të bindur SHBA-të që të vendosnin sanksione ndaj Moskës, për shkak të refuzimit të Ukrainës ndaj propozimit të Trumpit për një armëpushim 30-ditor, sipas diplomatëve evropianë.

Zelensky nuk kishte zgjidhje tjetër, përveçse të pranonte ftesën e Putinit për bisedime në Stamboll këtë javë, nga frika se mos e fyente Trumpin, sipas diplomatëve.

Putin e bëri ofertën për të mos larguar presidentin amerikan, dhe për të shmangur presionin gjithnjë e më të madh evropian ndaj Trumpit, për të vendosur sanksione më të ashpra.

Në një fjalim në Bundestagun gjerman për të shënuar Ditën e Fitores (VE Day) javën e kaluar, presidenti gjerman Frank-Walter Steinmeier theksoi nevojën e dyfishtë që Evropa të jetë e përgatitur për luftë.

“Lufta agresive e Rosisë e ka shkatërruar rendin e sigurisë evropiane, e ushqyer nga mashtrimi imperialist se lufta në Ukrainë mund të krahasohet me luftën e madhe patriotike”.

Ai shtoi: “Fakti që tani edhe Shtetet e Bashkuara, të cilat bënë kaq shumë për të krijuar dhe formësuar këtë rend, po i kthejnë shpinën atij, është një tronditje e një niveli krejtësisht të ri. Prandaj flas për një ndryshim epokal të dyfishtë – lufta e agresionit e Rosisë dhe shkëputja e SHBA nga vlerat e veta – kjo është ajo që shënon fundin e këtij shekulli të gjatë të 20-të.”

Evropa, këmbënguli ai, duhet të vendosë vetë se çfarë do të ndodhë më pas. / *The Guardian* – Bota.al



NARCISISTËT: TË “FSHEHUR”, PARA SYVE TË TË GJITHËVE

Jo të gjithë narcisistët janë egocentrikë të zhurmshëm, sipas një numri gjithnjë në rritje studimesh shkencore. Ekzistojnë edhe manipulues të fshehtë që rrinë në hije brenda shumë rretheve shoqërore

Narcizmi duket se ka arritur përmasa pandemike. Fëmijët po e quajnë njëri-tjetrin narcisistë në oborrin e shkollës. Dhe përse të mos e përdorin këtë etiketë edhe fëmijët? Është bërë modë që të rriturit ta përdorin për ish-të dashurit, shëfat, madje edhe për anëtarët e familjes.

Të gjithë mendojmë se kemi takuar një narcisist, ndoshta më së shumti përmes Carly Simon-it, kënga e së cilës You're So Vain flet për një tip aq egoist sa që në refren ajo këndon: “Me siguri mendon se kjo këngë është për ty.” Por a është narcisizmi gjithmonë po aq i dukshëm sa dikush që hyn në një festë, sikur të ishte duke “hipur në një jaht”?

Studimet e fundit sugjerojnë që jo.

Edhe pse, narcisizmi mund të jetë shumë më i përhapur nga sa është menduar më parë. Çrregullimi klinik i personalitetit narcisist vlerësohet se prek një në 20 persona, duke sugjeruar se secili prej nesh ka të ngjarë të njohë dikë me këtë gjendje.

Ndoshta ata janë në të njëjtën sallë me ty tani. Këta janë njerëz me ndjenjë epërsie dhe që mendojnë se kanë gjithmonë të drejtë – njerëz që shfaqin nivele të ulëta empatie, kërkojnë vazhdimisht admirim dhe lëndohen kollaj. Shifra një në 20 është vetëm një vlerësim, megjithatë. “Shifra reale ka gjasë të jetë më e lartë,” paralajmëron Claire Hart, profesore e asociuar e psikologjisë në Universitetin e Southampton-it. Kjo sepse njerëzit me iluzione madhështie mund të hezitojnë të pranojnë që kanë një problem dhe të kërkojnë ndihmë – prandaj e shmangin diagnozën.

Ka edhe një çështje tjetër që e bën përlogaritjen edhe më të vështirë. Përveç atij tipi të dukshëm të narcisistit ‘madhështor’ të cilit i këndon Carly Simon, psikologët tashmë kanë identifikuar edhe një formë më pak të njohur – narcisistin ‘e ndjeshëm’ (vulnerable), që është shumë më i fshehtë dhe më i vështirë për t’u dalluar... nëse nuk njih shenjat dalluese.

Sinjalet alarmante

Njerëzit që marrin pikë të larta në testet e narcisizmit madhështor janë zakonisht ashtu siç ne i presim: Studimet e shumta kanë treguar se këta individë kanë prirje të mburren shumë, të jenë arrogantë, të kërkojnë vëmendje dhe të ndihen të kënaqur me veten. Këta njerëz janë shumë ekstrovertë, të aftë në marrëdhënie shoqërore dhe, në fund të fundit, kanë shëndet mendor të shkëlqyer.

Ndërkohë, narcisistët e fshehur, të ndjeshëm nuk janë kështu. Ndërsa ata madhështorët priren të mos kenë thuajse fare dyshim tek vetja, ata me formën e ndjeshme të narcisizmit janë të pasigurt – të fiksuar pas mbrojtjes së imazhit të tyre superior.

Narcisistët e ndjeshëm, që përpiqen vazhdimisht të shmangin dëshimin, janë natyrisht shumë më pak të lumtur se ata madhështorët dhe kanë prirje drejt ankthit dhe depresionit.

“Narcisisti i ndjeshëm është shumë i brishtë dhe nuk përbal-

lon dot kritikën,” shpjegon Hart. Një studim i fundit, që vlerësoi nivelet e narcisizmit tek 676 të rritur në SHBA, tregoi se si narcisistët madhështorë ashtu edhe ata të ndjeshëm udhëhiqen nga dëshira për status shoqëror.

Por ndryshe nga madhështorët, narcisistët e ndjeshëm ndihen sikur nuk e kanë marrë statusin që meritojnë. Autorët e studimit arritën në përfundimin se narcisistët e ndjeshëm mund të tërhiqen nga konkurrenca me të tjerët nëse mendojnë se nuk do të kenë sukses.

“Kjo mund të çojë në rritje të stresit dhe ndjenja më të forta turpi,” thotë Hart.

Sipas të njëjtut studim, narcisistët e ndjeshëm gjithashtu ndihen të përjashtuar nga grupet shoqërore më shumë sesa do të dëshironin. (Narcisistëve madhështorë nuk u bëhej aspak vonë për përfshirjen – ata thjesht ndihen shumë më lart se ‘populli i zakonshëm’.)

Në fund, të dyja llojet e narcisistëve ndihen superiorë dhe të privilegjuar dhe mund të kalojnë shumë kohë duke fantazuar për suksesin e tyre – qoftë për pushtet, qoftë për bukuri.

Tipi i ndjeshëm mund të mos jetë aq i hapur për këto fantazi, por reagon ashpër kur imazhi i vet kërcënohet nga kritika apo konkurrenca.

“Nuk e di kur do të shpërthejnë,” thotë Hart. Por kur ndëshkimi është në mendjen e tyre, narcisistët e ndjeshëm janë më të prirur të jenë pasiv-agresivë.

Edhe pse nuk ka shumë kërkime për këtë, mund ta imagjinosh si mund të shfaqet në një ambient pune.

Nëse je në një mbledhje dhe shefi të lavdëron publikisht, ndërsa kontributi i kolegut narcisist të ndjeshëm shpërfilllet, ai mund të të thotë se është i lumtur për ty përballë teje. Por pas krahëve, shpjegon Hart, mund të minimizojë kontributin tënd para të tjerëve dhe të thotë se vetë ka pasur rolin kryesor.

Ka edhe shenja të tjera.

Gjatë një takimi pas pune në pub, mund t’i gresh duke të bërë pyetje të thella për jetën tënde, për të zbuluar informacione që më vonë mund t’i përdorin kundër teje.

Hart thotë se ndryshe nga narcisistët madhështorë, një narcisist i ndjeshëm mund të jetë më i rezervuar për të treguar gjëra për veten.

Dhe nëse ke fatin e keq që një i tillë të jetë menaxheri yt, dhe ai zbulon se ke kërkuar këshilla tek një menaxher më i lartë, mund të të përjashtojë, të të mohojë mundësi të ardhshme dhe të të përgojë përpara të tjerëve, thotë Hart.

Qartësisht, të dyja llojet e narcisistëve kanë prirje të reagojnë ndaj njerëzve përreth në mënyra antagonistë – nivele të larta narcisizmi lidhen me bullizëm, dhunë dhe agresion, të drejtpërdrejtë apo jo.

Por narcisisti i ndjeshëm mund ta bëjë këtë për arsye të ndryshme nga madhështori.

“Ata mund të bullizojnë ose të përdorin dhunë sepse ndihen të pasigurt për veten,” thotë Hart.

“Duhet të kemi kujdes ndaj tyre.” Kjo është veçanërisht e vërtetë



nëse mendon se je në një marrëdhënie romantike me një të tillë. S’është për t’u habitur që narcisistët madhështorë janë gjithmonë në kërkim të dikujt më të mirë – ata ndihen sikur meritojnë më të mirën – gjë që shpesh çon në tradhti.

“Narcisistët e ndjeshëm, nga ana tjetër, kanë më shumë nevojë për t’u përkujdesur, por gjithashtu mund të jenë kontrollues dhe manipulues në mënyra më të fshehta,” shpjegon Hart.

Edhe nëse narcisistët e ndjeshëm arrijnë ta fshehin këtë anë përballë disa njerëzve, do të jetë shumë e vështirë ta bëjnë këtë në një marrëdhënie afatgjatë.

“Ndonjëherë, në një marrëdhënie të shëndetshme, duhet të jemi në gjendje të themi çfarë na pëlqen apo s’na pëlqen,” thotë Nadja Heym, profesore e psikologjisë së personalitetit në Universitetin Nottingham Trent. “Dhe nëse nuk mund ta bëjmë këtë, sepse tjetri ndihet i kërcënuar – reagon tepër dhe bëhet agresiv – atëherë do të lindin probleme në marrëdhënie.”

Tipar që ndryshon

Tani për tani, ndoshta je i bindur që dikush në jetën tënde është një narcisist i plotë, i thellë, pa filtër dhe i fshehur.

Por ai person mund të mos jetë prekur nga një çrregullim i plotë i personalitetit.

Është e rëndësishme të mbajmë parasysh që tiparet narcisiste mund të vijnë dhe të ikin, në varësi të situatës – gjë që ndonjëherë na çon në etiketimin e gabuar të njerëzve si narcisistë. Ka rrethana që mund të nxjerrin në pah më të keqen nga të gjithë ne – duke shfaqur atë që studiuesit e quajnë “narcisizëm kontekstual”.

Nëse dyshon që dikush në një marrëdhënie toksike apo në një ambient pune shumë konkurrues është narcisist, ndoshta janë pikërisht këto rrethana që po ushqejnë sjelljen narcisiste. Ndoshta në një ambient më të qetë, ai person nuk do të ishte fare narcisist.

“Narcisizmi nuk është diçka që ose e ke ose nuk e ke, si një këmbë e thyer,” thotë Heym. Përkundrazi, të gjithë ndodhemi diku në spektër. Tiparet narcisiste mund të forcohen apo dobësohen me kalimin e kohës, të nxiten nga situata të caktuara dhe të shfaqen në forma të ndryshme, në mënyra të ndryshme të njerëz të ndryshëm. Kjo do të thotë se të gjithë jemi narcisistë – deri në një farë mase.

Ndryshe nga njerëzit me çrregullim të diagnostikuar të personalitetit narcisist, njerëzit me nivele të larta të tipareve narcisiste mund të jenë në gjendje t’i “zbusin” këto prirje në situata të caktuara, për shembull kur janë pranë familjes.

Ndryshe nga çrregullimi klinik, tiparet narcisiste janë të zakonshme dhe po bëhen gjithnjë e më të përhapura në shumë vende të

botës.

Për shembull, një meta-analizë mbi narcisizmin në universitetet amerikane tregoi se ky është rritur ndjeshëm mes viteve 1985 dhe 2006.

Përjashtim ishte Kalifornia, ku autorët sugjeruan se rritja e madhe e studentëve me prejardhje aziatike – që mund të jenë ndryshe në aspektin kulturor – mund të jetë arsyeja.

Një test i zakonshëm për të vlerësuar tiparet narcisiste quhet “Inventari i Personalitetit Narcisist”. Ai përbëhet nga 40 pyetje me dy alternativa, ku merr zero nëse zgjedh përgjigjen më modeste dhe një pikë nëse zgjedh opsionin më narcisist.

Për shembull, mund të të pyesin nëse pajtohesh më shumë me: “Nuk jam më i mirë apo më i keq se shumica e njerëzve” apo me: “Unë jam një person i veçantë.”

Sipas Hart, rezultati mesatar në këtë test në Mbretërinë e Bashkuar është rreth 12 nga 40, ndërsa në SHBA arrin në rreth 16 nga 40.

(DISA PYETJE LIDHEN POSAÇËRISHT ME NARCISIZMIN E NDJESHËM.)

Ka shumë keqkuptime për narcisizmin.

“Kushdo që bën diçka të tmerrshme shpesh etiketohet si narcisist,” thotë Hart. “Por narcisizmi është kompleks.”

Zemër prej akulli?

Edhe pse studimet kanë dhënë rezultate të ndryshme mbi këtë temë, Heym ka treguar se disa narcisistë mund të kenë aftësinë për të ndjerë empati – gjë që e bën edhe më të vështirë identifikimin e tyre. Hart dhe kolegët e saj kanë studiuar posaçërisht empatinë në narcisizëm.

Në një nga seritë e studimeve, ata u kërkuar 88 studentëve të universitetit, të cilët kishin kryer vlerësim për tipare narcisiste, të shikonin një video për një grua, Jenny, e cila kishte përjetuar një ndarje traumatike. Në të njëjtën kohë, ritmi i zemrës së tyre u mat me një elektrokardiogram (ECG). Zbuluan se studentët me nivele të larta narcisizmi raportonin nivele më të ulëta të empatisë për gruan. Dhe në mënyrë befasuese, ritmi i zemrës së tyre ngadalësohej gjatë shikimit të videos – e kundërta e asaj që do të prisje tek dikush që ndjen empati.

Por ndodhi diçka interesante kur këtyre njerëzve iu kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të shihnin nga këndvështrimi i Jenny-t. “Kur u kërkuam të vendoseshin në vendin e saj, ritmi i zemrës së tyre u përshpejtua si reagim ndaj stimulit empatik – në të njëjtin nivel me një person me më pak tipare narcisiste, duke treguar se u prekën në mënyrë fiziologjike nga ajo që panë,” thotë Hart.

E gjitha kjo sugjeron se narcisistët kanë aftësinë për të ndjerë empati, por thjesht zgjedhin të mos e bëjnë shumicën e kohës. Dhe kjo ka kuptim. Nëse interesi yt kryesor është vetja, dhe je i gatshëm të manipulosh apo të tradhtosh të tjerët për të përfituar, atëherë “fikja” e aftësisë për të ndjerë empati është një avantazh.

Pse kaq shumë?

Pse jemi kaq shumë prej nesh narcisistë? Është e lehtë të mendosh se disa njerëz thjesht kanë gjenin për këtë. Por, ndonëse narcisizmi ka një përbërës gjenetik,

përvojat e jetës duket se kanë rëndësi më shumë – duke na dhënë disa sinjale se çfarë duhet të kërkojmë.

Deri më tani, dimë pak për përvojat që mund të çojnë në narcisizëm.

Heym thekson se studiuesit zakonisht thjesht pyesin njerëzit për fëmijërinë e tyre dhe përpiqen të nxjerrin përfundime nga kjo.

Idealja do të ishte ndjekja e njerëzve për një periudhë të gjatë kohe, duke dokumentuar me kujdes përvojat e tyre ndërsa monitorojnë edhe nivelet e narcisizmit.

Në mënyrë intriguese, një grup studiuesish ndoqi fëmijë për dy vjet dhe zbuloi se ata që kishin prindër që i mbivlerësonin, duke i lavdëruar se ishin më të veçantë se fëmijët e tjerë, kishin më shumë gjasë të shfaqnin më pas shenja narcisizmi. Po ashtu zbuluan se fëmijët që mermin feedback kontradiktor – ndonjëherë të mbivlerësuar dhe ndonjëherë të nënvlerësuar – kishin më shumë gjasë të zhvillonin narcisizëm të ndjeshëm.

Ndërkohë që narcisizmi madhështor është më i zakonshëm te burrat, narcisizmi i ndjeshëm është më i zakonshëm te gratë. Por kjo formë është studiuar shumë më pak. “Madje edhe klinikistët e ngatërojnë narcisizmin e ndjeshëm te femrat me çrregullime të personalitetit të tipit kufitar (borderline),” thotë Hart.

Plani i lojës

Po si të sillemi me një person me tipare të forta narcisiste? A mund ta ndihmojmë të bëhet më pak narcisist?



Meqë narcisizmi është pjesë e karakterit, është i vështirë për t’u trajtuar. Ndërsa karakteri ynë ndryshon paksa me kalimin e kohës, ai formësohet shumë nga përvojat në rini – dhe kjo e bën më të vështirë trajtimin e çrregullimeve të personalitetit, përfshirë narcisizmin.

“Me çrregullimin e stresit post-traumatik, për shembull, ne e dimë se çfarë e shkakton dhe mund të punosh me atë faktor,” thotë Heym. “Por me personalitetin, nuk ka një shkaktar të caktuar – thjesht është diçka që formohet gjatë 20 viteve të para të jetës.”

Studimet kanë treguar se njerëzit mund ta ndryshojnë paksa karakterin e tyre duke vepruar në një mënyrë që forcon një tipar të caktuar (p.sh. të flasësh me njerëz të rinj çdo ditë për t’u bërë më ekstravert). Por është e vështirë të thuhet nëse njerëzit me tipare narcisiste duan të ndryshojnë – apo nëse këto ndryshime zgjasin. “Është thuajse e pamundur të reduktohet narcisizmin përgjithmonë,” thotë Hart. “Ajo që duhet të bësh është të përpiqesh të rritësh empatinë.” Ajo shpjegon se meqë këta njerëz tashmë e zotërojnë aftësinë për të ndjerë empati, çdo ndërrhyrje duhet të fokusohet në motivimin e tyre për ta përdorur atë.

“Ne kemi punuar për vite të tëra për ta bërë empatinë më tërheqëse për narcisistët,” thotë ajo. Hart dhe kolegët e saj thonë se programet duhet ta rikonceptojnë empatinë si diçka që u sjell dobi narcisistëve – për shembull, duke u treguar se të shohësh nga perspektiva e të tjerëve ndihmon për të qenë lider më i mirë apo për të pasur sukses në biznes.

/ bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Oferta e Napolit për Zhegroven nuk e kënaq Lillen

Zyrtarët e Lilles janë shprehur jo të kënaqur me ofertën që kanë pranuar për Edon Zhegrovën. Siç raporton mediumi i afërt me klubin francez, "lepetitlillois", Napoli

ka ofruar vetëm 12 milionë euro për transferimin e Zhegrovës. Ndërkohë Lille kërkon 20 milionë euro për ta liruar sulmuesin e krahut. Zhegrova i ka munguar Lillet

që nga dhjetori i vitit të kaluar për shkak të një lëndimi, ndërsa nga situata e tij synon të përfitojë skuadra italiane duke ofruar vetëm 12 milionë euro. Zhegrova ka bërë me dje se nuk

do ta zgjasë kontratën e tij, duke lënë të hapur mundësinë për t'u larguar gjatë verës. Krahas Napolit, interesim për Zhegrovën kanë shprehur edhe disa klube të tjera. Zhegrova

26-vjeçar shënoi tetë gola dhe asistoi dy herë në 21 ndeshje në të gjitha garat e këtij edicioni. Ai me skuadrën e Lillet ka kontratë deri në verën e vitit të ardhshëm.

Trepça krenohet me suksese, Bashkimi synon të rikthehet më i fortë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 MAJ - KB Trepça është kampione për edicionin 2024/2025 në Superligën e Kosovës në basketboll. Pas triumfit me rezultat të përgjithshëm 4-2, Klubi nga Mitrovica ka shprehur krenari për suksesin e arritur, duke thënë se këto rezultate nuk ishin të rastësishme. "Dominim total. 'Back-to-back', finale pas finale, trofe pas trofe. Jemi kampionë. Nuk është rastësi, është Trepça", thuhet në postimin e Trepça. KB Bashkim ka pasur një sezon të jashtëzakonshëm në elitën e basketbollit të Kosovës, por në fund nuk arriti të kurorëzohet me titullin e kampiones. Në postimin e gjatë të kësaj skuadre, thuhet se sezoni 2024/25 tashmë ka përfunduar dhe se ishte një udhëtim i mbushur me sfida, përpjekje, emocione dhe, mbi të gjitha, me një bashkim të jashtëzakonshëm të të gjithë atyre që përbëjnë familjen portokall e zi. "Edhe pse nuk arritëm ta kurorëzojmë sezonin me trofe, nuk mungoi as përkushtimi, as zemra, as përpjekja. Çdo hap i bërë këtë vit ka qenë pjesë e një ndërtimi që do të vazhdojë të rritet dhe të forcohet. Lojtarëve tanë, faleminderit për çdo betejë të fituar e të humbur, për çdo pikë djerse në fushë dhe për krenarinë me



të cilën keni mbrojtur këto ngjyra. Stafit të trajnerëve, stafit teknik dhe mjekësor, mirënjohje për punën e palodhur, për profesionalizmin dhe kujdesin që keni treguar gjatë gjithë rrugëtimit", thuhet në postimin e Bashkimit. Ky klub i ka falënderuar sponsorët për besimin dhe përkrahjen dhe falë tyre është bërë i mundur rrugëtimi i këtij klubi çdo sezon. Po ashtu, është falënderuar edhe Kuvendi Komunal dhe DKRS-ja për mbështetjen e vazhdueshme dhe rolin e rëndësishëm në këtë rrugëtim. Ky klub synon të rikthehet edhe më i fortë në sezonin e ardhshëm. "Mbi të gjitha, tifozëve tanë, të flaktë – Arpagjikt, ju faleminderit që qëndruat pranë nesh – në fitore dhe në humbje. Jeni zemra e klubit tonë. Ju jeni

lojtari ynë i 6! Ky sezon mbyllet, por rrugëtimi ynë vazhdon. Me kokën lart, me zemër të bashkuar dhe me një synim të qartë: të rikthehemi më të fortë. Faleminderit, Prizren!", thuhet në postimin e Bashkimit. KB Trepçën për titullin kampion në basketboll e ka uruar edhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti. "Trepça kampione përsëri. Titulli i dytë radhazi dhe i gjashti në histori për minatorët e Mitrovicës që po vazhdojnë të dominojnë në basketbollin vendor. Përgëzime KB Bashkimit! Finalist dinjitoz që, përkundër humbjes, i dha hijeshi kampionatit të sivjetmë me rivalitet të fortë. Urime Trepçës, qytetit të Mitrovicës dhe 'Torcidës', që edhe këtë herë ishin zemra e fitores!", ka shkruar Kurti.

SHKURT

Kujtim Shala rikthehet te Dinamo e Zagrebit, pas 34 vjetësh

Lojtari i pëlqyer i tifozëve të Dinamos së Zagrebit, Kujtim Shala, po rikthehet në klubin e madh kroat, ka raportuar gazeta "24 sata". Shala, i cili jeton në Gjermani prej vitesh, ende ndjek gjithçka çfarë ndodh në klubin e kryeqytetit, dhe këto ditë ishte në Zagreb, ku ai dhe Zvonimir Boban ranë dakord për detyrimet e tij të punës për të ardhmen, shkruan media kroate. "Zvonimir Boban po e zgjidh çdo ditë strukturën për sezonin e ri dhe ditët e fundit, kreu i ardhshëm i drejtimit të Dinamos ka rikthyer në klub një tjetër emër të njohur. Skauti i ri i Dinamos do të jetë legjendari Kujtim Shala (60-vjeçar). Ish-ikona e tifozëve të 'kaltërve' po kthehet zyrtarisht te Dinamo për herë të parë që nga viti 1991, kur u largua nga Maksimir për te Rennes në Francë. Në nëntor të vitit 2024, Dinamo përforcoi shërbimin e saj të vëzhgimit duke sjellë Xhemal Mustedanagiq dhe Toma Shokota, tani në atë sektor po vjen edhe Kujtim Shala", shkruan "24 sata.hr".

Dy shqiptarë në listën e Gjermanisë U21

Gjermania U21 publikoi listën e parë me 26 emra, të gatshëm për Evropianin U21. Pjesë e saj janë edhe dy talente nga Shqipëria, pikërisht Nelson Veiper dhe Brajan Gruda. Lista me 26 lojtarë do të shkurtrohet në 23, numër që përkon me futbollistët e lejuar për listën përfundimtare. Evropiani U21 do të marrë jetë në Sllovaki përgjatë muajit qershor. Më 4 qershor ndërkohë do të dorëzohet lista zyrtare me 23 lojtarë. Ftesat e Grudës dhe Veiper ishin të pritshme për shkak të performancave të tyre respektivisht me Brajton dhe Mainz. Të dy lojtarët e moshës 20 vjeç pëlqehen nga trajneri Antonio Di Salvo. Gruda mund të luajë në mesfushë dhe sulm, ndërsa Veiper llogaritet për qendrën e sulmit.

Deco: PSG-ja e ka kërkuar Yamalin, Real i jo

Lamine Yamal vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes falë performancave të jashtëzakonshme në fushë, duke tërhequr vëmendjen e klubeve më të mëdha në Evropë. Një nga klubet që ka shfaqur interesim ka qenë Paris Saint-Germain, i cili, sipas drejtorit sportiv të Barcelonës, Deco, ka tentuar ta marrë talentin spanjoll. Në një intervistë për RAC-1, Deco zbuloi: "Kanë pasur oferta sezonin e kaluar, jo këtë. Të gjithë e dimë për këtë po flasim dhe sa vlen. Kur nuk do t'i dëgjosh ofertat, është e kotë. Por klubet pyesin gjithmonë. PSG-ja e ka kërkuar, Real Madridi jo". Barça duket e vendosur të mos dëgjojë asnjë ofertë për Lamine Yamal, të cilin e konsideron pjesë kyçe të projektit afatgjatë, ndërsa interesimi nga klubet e mëdha si PSG vetëm sa e rrit vlerën dhe rëndësinë e tij në kampin katalanas.

Rikthimi te Zvicra, Yakin dhe Shaqiri me qëndrime të kundërta

CYRIH, 22 MAJ - Përzgjedhësi Murat Yakin ka thënë se Xherdan Shaqiri e ka të hapur derën për kthim te Zvicra, por ka theksuar se vendimi i takon yllit të Baselit. "U përpoqa ta kontaktoja dje dhe i dërgova një mesazh zanor. E përgëzoja për fitimin e kampionatit dhe

paraqitjen e tij. Ne e respektuam vendimin e tij për t'u larguar nga përfaqësuesja. Ai e di rolin e tij dhe e luajti mirë në Kampionatin Evropian. Por, për mua, dera është ende e hapur. Do ta shqyrtojmë në të ardhmen, por ai duhet të jetë gjithashtu i gatshëm", ka

thënë Yakin. Shaqiri ka shpërthyer me gola e asistime këtë sezon, duke e ndihmuar Baselin ta kthejë titullin e kampionit. Në anën tjetër, Xherdan Shaqiri nuk e mendon për momentin kthimin te Zvicra. "Dera është e mbyllur për momentin", ka thënë Shaqiri.



Indiana fiton finalen e parë

INDIANAPOLIS, 22 MAJ - Indiana Pacers i nis me këmbë të mbarë finalen e “play-off”-it në Konferencën e Lindjes, duke fituar me rezultat 138-135 në fushën e New York Knicksit. Një ndeshje me rivalitet, e vendosur vetëm pas kohës shtesë, me

Pacersin që udhëheq kështu 1-0 serinë. Të gjithë titullarët e Indianas realizuan mbi 14 pikë, që e bën kolektivitetin armën më të fortë të kësaj skuadre. Tyrese Haliburton realizoi 31 pikë e 11 asistime, mbështetur edhe nga Nesmith me 30 pikë,

ndërsa 31 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Për New York u dalluan vetëm Jalen Brunson me 43 pikë e Karl-Anthony Towns me 35 pikë e 12 rebounde. Ndërsa pjesa tjetër e skuadrës mbeti në hije, ndërkohë që stoli i skuadrës

njujorkeze ishte inekzisent. Finalja e dytë do të zhvillohet pas dy ditësh sërish në New York, aty ku vendësit do të duhet patjetër të fitojnë për ta barazuar serinë përpara sesa bonusi i të luajturit në shtëpi të kalojë në favor të Pacersit, me



serinë që do të zhvendoset në Indianapolis.

Tare firmos të hënën me Milanin

MILANO, 22 MAJ - Pas muajsh të tërë zërash, analizash dhe emrash të përfolur, Milan ka vendosur përfundimisht: Igli Tare do të jetë drejtori i ri sportiv i klubit kuqez, duke nisur nga sezoni 2025/26. Ish-drejtuksi i Lazios pritet të firmosë të hënën një kontratë trevjeçare (me formulën 2+1 në favor të klubit) me pagë neto prej 800 mijë eurosh në sezon. Vendimi për ta përsheptuar emërimin e Tares u mor nga pronari i RedBird, Gerry Cardinale, pas humbjes zhgënjyese të Milanit ndaj Romës që i kushtoi me vend në garat evropiane. 24 gola në Kategorinë e Parë shqiptare, sulmuesi merr ftesë nga kombëtarja pas një takimi mes Cardinales dhe administratorit të deleguar, Giorgio Furlani, u arrit një marrëveshje verbale që i hap rrugë zyrtarizimit. Sipas “Calciomercato.com”, baza e parë e marrëveshjes mes Tares dhe Milanit ishte hedhur më 16 prill, gjatë një takimi në Romë. Më pas, duke parë se alternativat nuk ishin të realizueshme, kuqezinjtë



vendosën të ecnin me Taren, një figurë që ka pasur përkrahjen edhe të Zlatan Ibrahimoviçit, dhe që gëzon një raport shumë të mirë me Geoffrey Moncada. Dyshja do të punojë ngushtë për zgjedhjen e trajnerit të ri dhe për strategjinë e merkatos, si për përforsimet, ashtu edhe për largimet e mundshme. Vendimet përfundimtare do të mbeten në dorë të CEO-s, Giorgio Furlani, por Tare, i cili aktualisht është pa

kontratë, do të jetë menjëherë operativ. Të hënën pritet firma mbi kontratë, që do ta bëjë zyrtarisht pjesë të projektit të ri teknik të Milanit. Kuqezinjtë synojnë të rikthehen fuqishëm në Ligën e Kampionëve dhe të ndërtojnë një skuadër konkurruese përmes një projekti ambicioz dhe me vizion afatgjatë, ku përvoja dhe njohuritë e Igli Tares në merkato pritet të luajnë një rol kyç.

Postecoglou: Jam trajner fitues. Amorim: Nuk jap dorëheqje

MANCHESTER, 22 MAJ - Ishte në buzë të greminës, por në fund Ange Postecoglou arrin ta shpëtojë veten dhe Tottenham Hotspurin. Tekniku australian shkruan historinë, në vitin e tij të dytë në krye të “gjelave”, në ndeshjen e tij të 100 në Londër, arrin t’i dhurojë një trofe shumë të rëndësishëm: “Më duken më shumë se 100 ndeshje, por kjo është një ditë speciale, kemi punuar shumë për këtë. Tifozët e meritonin një trofe. Kritikë që kam marrë? Ka qenë e vështirë, por kam besuar gjithnjë në instinktin tim. E dija që mund të ndryshoja diçka këtë vit. Ua kam thënë gjithnjë djemve se mund t’ia dilnim. Jam shumë i lumtur për këtë”. “E ardhmja ime? Jam totalisht i përqendruar për të festuar këtë sukses, çfarë do që të ndodhë, do të ndodhë. Unë jam trajner. Këto vendime nuk janë në dorën time, nuk më takojnë mua. Mua më intereson vetëm kjo medalje. Kjo do të thotë se kemi



fituar një trofe. Jam një trajner fitues”, u shpreh Postecoglou. Pa diskutim e ndryshme është situata në radhët e Manchester Unitedit. Ruben Amorim erdhi në “Old Trafford” si një shpresë e madhe për t’i shpëtuar “djajtë e kuq”, por fundi ishte i hidhur për teknikun portugez. Pas finales së humbur, i gjithë diskutimi u kthye në lidhje me të ardhmen e tij, a do

të vijojë të jetë trajner i Manchester Unitedit: “Unë jam i hapur. Nëse drejtuesit dhe tifozët mendojnë se unë nuk jam njeriu i duhur, unë largohem, madje edhe pa menduar për paratë, por unë nuk jap dorëheqje. Unë kam besim te puna që bëj. Nuk jam këtu për ta mbrojtur veten, se nuk është në stilin tim”, u shpreh Amorim.

Fernandes: Nëse klubi dëshiron mund të largohem

Mesfushori portugez Bruno Fernandes ka thënë se është i gatshëm të largohet nga Manchester Unitedi nëse nuk është më i mirëpritur në klub. Humbja nga Tottenhami në finalen e Ligës së Evropës ka

lënë shije të hidhur tek Unitedi, por mund të ketë edhe një efekt negativ në ekip, ku drejtuesit mund të detyrohen të shesin lojtarë. “Gjithmonë kam qenë i ndershmë”, ka thënë fillimisht kapiteni i ekipit pas humbjes 1-

0 të Unitedit ndaj Tottenham Hotspurit në finalen e Ligës së Evropës. “Nëse klubi mendon se është koha të ndahemi sepse dëshiron të fitojë para ose diçka të tillë, kështu është. Futbolli ndonjëherë është kështu.

Gjithmonë kam thënë se do të jem këtu derisa klubi të më thotë se është koha për t’u larguar. Jam i etur të bëj më shumë, që të jem në gjendje ta çoj klubin në ditët e mëdha. Ditën që klubi mendon se jam i

tepërt ose është koha të ndahemi, futbolli është kështu, nuk e di kurrë. Por unë gjithmonë e kam thënë dhe e mbaj fjalën time në të njëjtën mënyrë”, ka deklaruar Fernandes.

SHKURT

Zvicra fton Xhakën dhe Jasharin për miqësorët e qershorit

Zvicra do të jetë e angazhuar në Amerikën e Veriut, ku do t’i zhvillojë dy ndeshje miqësore kundër Meksikës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Selektori Murat Yakin e ka zbuluar sot listën e 26 futbollistëve të ftuar të “helvetikëve”, ndërsa në mesin e tyre janë edhe dy futbollistë nga Kosova. Në fakt, në kombëtare do të rikthehet Granit Xhaka, ndërsa pjesë e ekipit do të jetë edhe shqiptari tjetër Ardon Jashari. Lista e të ftuarve: Kobel, Keller, Mvogo, Akanji, Amenda, Blondel, Elvedi, Garcia, Gartenmann, Muheim, Rodriguez, Schmidt, Widmer, Zesiger, Aebischer, Amdouni, Embolo, Freuler, Jashari, MonzAmbi, Ndoeye, Rider, Sierro, Sow, Xhaka, Zakaria.

Flick vazhdon kontratën me Barçën


Trajneri i Barcelonës, Hansi Flick, ka zgjatur kontratën deri në qershor të vitit 2027, njoftuan kampionët spanjollë. Gjermani e udhëhoqi Barçën drejt tripletës vendase, duke fituar La Ligën, Kupën e Mbretit dhe Superkupën e Spanjës në vitin e tij të parë në krye të klubit. “Barcelona dhe Hansi Flick kanë arritur një marrëveshje për rinovimin e kontratës së tij, e cila do ta lidhë atë me klubin deri më 30 qershor 2027”, thuhet në njoftimin e Barcelonës. Flick zëvendësoi Xavi Hernandezin pasi Barcelona e përfundoi sezonin e kaluar pa një trofe dhe ka pasur një ndikim të shpejtë në Katalonjë.

Schmeichel: Nuk dëgjoj kritikën, qëndroj në kombëtare

Pavarësisht prej kritikave, portieri danez Kasper Schmeichel do të vijojë të qëndrojë te kombëtarja. Konfirmimi ka ardhur nga vetë 38-vjeçari në një intervistë për “Daily Mail”. “Unë nuk kam lexuar asnjë fjalë nga ato që janë shkruar për mua. Futbolli është sporti më i popullarizuar në botë dhe të gjithë kanë mendime, gjë që është normale dhe diçka e mirë. Kur isha fëmijë, ëndrra ime ishte të luaja për Kombëtaren dhe ta vishja fanellën e Danimarkës. Të jem kapiten dhe të kem luajtur kaq shumë ndeshje është gjëja më e madhe për mua si futbollist”, ka thënë Schmeichel.

Modriqi do të largohet nga Reali

Mesfushori Luka Modriq nuk do të jetë pjesë e Real Madridit sezonin e ardhshëm pasi do të largohet nga klubi sapo të përfundojë botërori i klubeve. Modriqi do të largohet si lojtar i lirë, pasi klubi vendosi që mos t’ia rinovojë kontratën që i skadon më 30 qershor përkundër dëshirës së kroatit që ta mbyllë karrierën në “Santiago Bernabeu”. Kështu që, Modriqi do të jetë lojtar i lirë dhe ndeshjen e fundit me fanellën e Realit në La Liga do ta zhvillojë të shtunën mbrëma kundër Real Sociedadit. Modriqi largohet nga Reali me një trashëgimi të padiskutueshme, me 28 trofe të fituar dhe një “Top të Artë” në vitin 2018. 39-vjeçari prej vitit 2012 ka qenë pjesë e Realit dhe në total ka regjistruar 590 paraqitje, duke shënuar 42 gola. Lamtumira e Modriqit nuk do të jetë e vetmja emocionale të shtunën, pasi edhe Carlo Ancelotti e Lucas Vazquez do t’i japin lamtumirën klubit.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Kamila” shpk, Malësi e Re, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Ndërtimin e Sistemit Solar Fotovoltaik me fuqi 200 kWp, mbi kulmin e objektit të kompanisë “Kamila” shpk në Lutogllavë, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.07.2025 në ora 10:00 në SH.F.M.U “Dëshmoret e Kabashit” fshatin Korishë të Prizrenit, do të organizohet debat publik nga Kompania “Kamila” shpk, Malësi e Re, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsviMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Kamila” shpk, Malësi e Re, Prizren, për Pëlqim Mjedisor, – për Ndërtimin e Sistemit Solar Fotovoltaik me fuqi 200 kWp, mbi kulmin e objektit të kompanisë “Kamila” shpk në Lutogllavë, Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte



RESTAURANT
SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “BLC-Trade” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 71358240.

- Fatmire Zeka shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “Zenel Hajdini” Prishtinë.

- Blerta Preteni shpall te pavlefshme diplome e shmlm “Dr Xheladin Deda”.

- Astrit Shartari shpall te pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12,13 dhe certifikatën e shmlt “Arkitekt Sinani”.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar,


lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve “ALBED” në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



AHSEN (Kinzolli) RAMADANI
(05.12.1946 – 23.04.2025)

Sot u bë një muaj që nuk je më mes nesh, por zemrat tona vazhdojnë të të ndiejnë pranë. Ikja jote na la boshllëk, por dashuria jote na mbulon ende si një lutje që nuk hesht.
Na mungon gjithçka e jote.
Ti ishe zemra e familjes
dhe je, përjetësisht, një pjesë e shpirtit tonë.

Pusho në paqe, e dashura jonë.
Të kujtojnë me mall dhe dashuri:
djemtë Lulzimi dhe Besimi,
vajzat Luljeta, Dashuria, Nerxhivani dhe Nashidja,
si dhe mbarë farefisi Kinzolli-Ramadani.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC
cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1909
0.5L